



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.10(436)

TETOR 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANI0BVL.ORG

80 VJETORI I ÇLIRIMIT


KUSH ISHIN DREJTUESIT E NJËSIVE TË MËDHA PARTIZANE



Sakip CAMI

FAQE 2

IN MEMORIAM



FADIL HOXHA, FIGURË E SHQUAR E HISTORISË KOMBËTARE

Nga Bashkim Hisari

FAQE 6

87 VJETORI I RËNIES

LUFTËTARI NDËRKOMBËTAR, ASIM VOKSHI

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zota



FAQE 7

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përgëzoi të rinjtë për zgjedhjet e kësaj rruge që kërkon sakrificë

239 VAJZA E DJEM, TË GATSHËM TË BËHEN PJESË E FA

Rishkrimi i historisë si domosdoshmëri

Halil RAMA

Siç është bërë e ditur, Akademia e Shkencave ka ngritur një komision të posaçëm për rishkrimin e Historisë së Shqipërisë. Në këtë komision bëjnë pjesë profesorë dhe akademikë të njohur. Gjithsesi, OBVLP, duke e parë si domosdoshmëri, sidomos rishkrimin e Historisë së LANÇ, apelon që ky Komision të konsiderojë botimet e fundit të dëshmitarëve okularë të asaj lufte heroike. Ndër ta, Hamit Keçi dhe Edip Daci, dy akademistë, që pasi refuzuan betimin fashist në Akademinë Militare në Modena ku kishin studjuar, u rreshtuan në Lëvizjen Antifashiste që në njësitët guerrile të Tiranës, kanë lënë kujtime për ngjarje të rëndësishme, të cilat janë botuar në dy libra. Po ashtu, Prof. Paskal Milo, në disa emisione televizive me logon “Dritëhije të personaliteteve historike” ka nxjerrë fakte të reja, ndër të cilat për qëndrimin në LANÇ të dr. Ymer Dishnicës, gjeneral Dalil Ndreut, Nako Spiros, Sejfulla Malëshovës, Liri Belishovës e dhjetra personaliteteve që drejtuan luftën. Drejtuesi i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Prof. Maringlen Verli, në një intervistë për një nga televizionet kombëtare ka thënë se rishkrimi i historisë është një proces i vazhdueshëm bazuar në dokumente, fakte dhe metodologji të reja. Verli do të pasqyrojë historinë e Kosovës mes dy luftërave. E ku padyshim një vëmendje të veçantë zë edhe debati mbi Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, krijuar në vitin 1918 dhe i zhbërë nga Ahmet Zogu. Rishkrimi i historisë është një domosdoshmëri për drejtuesin e Akademisë së Studimeve Albanologjike Maringlen Verli. Piketat e tri vëllimeve për historinë e shqiptarëve, do të kenë shtrirje të gjerë në kohë dhe hapësirë thekson historiani.



Mes 239 kandidatëve të kualifikuar në përfundim të procesit të rekrutimeve për ushtarë/detarë, të drejtën për të vijuar kursin e kanë edhe 33 vajza; 25 kandidatë janë me arsim të lartë; 160 me arsim të mesëm dhe 54 kandidatë janë me arsim 9 – vjeçar

FAQE 12 - 13

REPORTAZH

PËRMETI I ZBUKURUAR PËR 81-VJETORIN E ÇLIRIMIT, FESTON DITËN E LIRISË

Muharem Kamani

FAQE 16

SUPLEMENTI LETRAT



REALIZIMI I ËNDËRRËS SË YMER BERBATIT PËR KOSOVËN E LIRË

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14

REFLEKSIONE

BIJTË E VETERANËVE SI TRASHËGUES TË DENJË TË PARAARDHËSVE TË TYRE

Nga MEVLUD BUCI

FAQE 9

QASJE PËR NJË LIBËR ARKIV

Nga Liljana Muça

FAQE 15

80 VJETORI

RRUGA E LAVDISHME HEROIKE E BRIGADAVE TË 3-të, 9-të DHE 24 S PARTIZANE

FAQE 4,5,10

OPINION

“5 PËRGJIGJE NDAJ TURFULLIMEVE TË Z. VUÇIÇ PËR LUFTË”?!

Gjeneral @ Piro Ahmetaj

FAQE 11

IN MEMORIAM

MEHMET HYSENAJ NGA REÇI, NJERIU DHE USHTARAKU MODEL

SHAQIR ÇERPJA

FAQE 8

PROFILI

KAPEDAN DHE PRIJËS ÇETE BILBIL SHAKAJ, DËSHMOR I ATDHEUT

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEM

FAQE 12

ESSE

KULLA E CURRAJVE DHE CURRAJT NË HISTORI

Nga Prof. Naun Kule


FAQE 13

HISTORIA

80 vjetori i çlirimit të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë

Kush ishin drejtuesit e njësive të mëdha partizane

Gjeneral Spiro Moisiu



Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare

10 korrik 1943

Major Abaz Kupi (1891-1976)
Myslym Peza, (1897 – 1984)
Major Spiro Moisiu (1900 – 1981), komandant i Shtabit
Baba Faja Martaneshi (Mustafa Xhani) 1910 – 1947)
Haxhi Lleshi (1913 – 1998)
Dali Ndreu (1912 – 1956)
Dr. Ymer Dishnica (1912 – 1998)
Ramadan Citaku (1914 – 1990)
Enver Hoxha (1908 – 1985), komisar i Shtabit
Mustafa Gjinishi (1912 – 1944)
Bedri Spahiu (1908 – 1998)
Sejfulla Malëshova (1900 – 1971)

Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u bënë ndryshime:

Ymer Dishnica e Sejfulla Malëshova kaluan në detyra të reja si anëtarë të Komitetit Antifashist NÇ dhe dy të tjerë, kolonel Hysni Kapo e kolonel Islam Radovicka do të zgjidheshin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm si dhe gjeneralmajor Mehmet Shehu, pas çlirimit të Tiranës.

DREJTUESIT E BRIGADAVE SULMUESE

Brigada e I, 16 gusht 1943, Vithkuq

Mehmet Shehu, komandant i Br I dhe Div I
Tuk Jakova, Komisar i Br I, komisar Div I dhe komisar Korp III
Arif Hasko, komisar i Brigadës, pas Tuk Jakovës
Tahir Kadare, zv Komandant i Br I, komandant i Br 6, komandant i Korp II
Muhamet Prodani, komandant i Br I
Todi Naco, komandant i Artilerisë së Brigadës
Brigada e II, 20 nëntor 1943, Shëngjergj
Beqir Balluku, Komandant i Br II,
Vasil Konomi, Komisar i Br II, Gani Goxhi komisar

Irakli Bozo, Zv komandant i Br 2, Komandant i Br 9
Kico Ngjela, Zv Komisar

Brigada III, 9 tetor 1943 Arbanë

Hulusi Spahiu, Komandant i Br III
Shahin Ruka, Komisar i Br III,
Hamit Keci, Zv Komandant,
Vasil Nathanaili, Zv Komisar

Brigada e IV, 28 dhjetor 1943, Voskopojë

Nexhip Vincani, Komandant,
Pllumb Dishnica, komisar,
Josif Pashko, Zv Komisar

Brigada V, 20 janar 1944, Tërëbac, Vlorë

Abas Shehu, komandant, më pas Shefqet Peci
Hysni Kapo, komisar
Dervish Hekali, zv komandant
Manush Myftiu, zv komisar

Brigada VI, 26 janar 1944, Përmet

Tahir Kadare, komandant
Mustafa Matohiti, komisar
Riza Veipi, zv komandant
Jaho Gjolicu, zv komandant
Haki Toska, zv. Komisar
Sotir Filto, zv komandant
Xhule Ciraku, zv komisar

Brigada VII, 17 mars 1944, Vlushë, Skrapar

Gjin Marku, komandant i Br VII, më pas Musa Daci komandant
Kadri Hoxha, komisar i Br. VII, më pas Qazim Kapisyzi
Neshat Hysi, zv komandant
Adil Carcani, zv komisar
Ramiz Alia, përgjegjës rinie

Brigada VIII, 23 prill 1944, Sheper

Asaf Dragoti, komandant Br
Qazim Kondi, komisar
Koco Gjeci, zv komandant

Rahman Parllaku zv komisar

Brigada IX, 16 tetor 1944, Llozhanë

Irakli Bozo, komandant
Mihallaq Zicishti, komisar
Petro Papi, zv. Komandant

Brigada X, 6 nëntor 1944, Karbunarë

Koco Gjeci (Papa), komandant
Mane Nishova, komisar
Njazi Cepani, zv komandant, komandant
M. Bllaci, zv komisar

Brigada XI, 1 tetor 1944, Fier

Mevlan Dervishi, komandant
Halil Pulo, komisar
Dilaver Poci, zv komisar, komisar, komandant

Brigada XII, 20 maj 1944, Sukë

Refat Bajrami, komandant
Qemal Klosi, komisar
L.Jaho, zv komandant
Rahman Parllaku, zv komisar

Brigada XIV, 17 gusht 1944, Sheper

Gjon Banushi, komandant
Kahreman Ylli, komisar
Halil Kacanolli, zv komandant
Gafur Cuci, zv komisar

Brigada XV, 29 qershor 1944, Protopapë

Teki Kolaneci, komandant
Shahin Ruka, komisar
H.Babani, zv komandant
V.Koleci, zv komisar

Brigada XVI, 20 gusht 1944, Therepel

Rahman Ruci, komandant
Abdyl Këllezi, komisar, më pas Sofo Papajani komisar
Gjon Gjoni zv komandant
Myzafer Trebeshina, zv komisar

(Vijon ne faqen 3)

HISTORIA

80 vjetori i çlirimit të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë



Rahman Parllaku



Tuk Jakova

Kush ishin drejtuesit e njësive të mëdha partizane

(Vijon nga faqja 2)

Brigada XVII, 26 shtator 1944, Gjinari, Elbasan
Gjeli Argjiri, komandant
Qamil Guranjaku, komisar
Sefedin Mece, zv komandant
Ndreci Plasari, zv komisar

Brigada XVIII, 18 gusht 1944, Sllatinë, Dibër
Esat Ndreu, komandant
Petrit Dume, zv komandant, komandant
Zoi Themeli, zv komandant, komandant,
Xhevdet Petrela, zv komandant, komandant
Teme Sejko, zv komisar
Mico Kallamata komisar,
Ilmi Causholli komisar
Sotir Vullkani Zv.komisar,
Milo Qirko zv komisar, komisar

Brigada XIX, 20 gusht 1944, Theollog
Andrea Nasi, komandant, Thoma Xhixho komandant
Vangjo Mitrojorgji, komisar
Mehmet Dusha, zv komandant
Lefter Kasneci, zv komisar,
Spiro Xhai, Zv komisar

Brigada XX, 9 shtator 1944, Protopapë
Riza Kodheli, komandant
Misto Treska, komisar
Llambi Premti, komisar
Isuf Keci, zv komandant
Nuri Resnja, zv komisar

Brigada XXII, 18 shtator 1944, Pezë
Sali Verdha, komandant,
Rexhep Zuna, komandant (dëshmor), Neshat Hysi komandant
Tonin Jakova, komisar
Shaban Rexha, zv komandant
Sadik Bocaj, zv komisar
Nimet Ymeri, zv komisar, komisar

Brigada XXIII, 21 shtator 1944, Zall Mner
Hamit Keci, komandant, më pas Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani
Xhavit Qesja, komisar, Mërkur Cela komisar
Haki Fejzo, zv komandant, Rexh Deliu, zv komandant
Sejdin Avdia, zv komisar, komisar

Brigada XXIV, 4 tetor 1944, Bicaj
Ndreko Rino, komandant,

Abedin Shehu, komisar
Et'hem Gjinushi, Zv.komisar, komisar
Nj.Hoxha, zv.komandant

Brigada XXV, 6 nëntor 1944 Tropojë
Rexhep Haka komandant, V.Daci, komandant
Nuri Arapi, komisar, Sadik Bekteshi komisar
Sh.Hoxha, zv komandant

Brigada XXVII, 29 nëntor 1944, Shkodër
Qazim Kapisyzi, komandant
Sadik Bekteshi, komisar

DREJTUESIT E DIVIZIONEVE

Divizioni I
Me përbërje Br 1, 4, 5,
Komandantë Dali Ndreu, Mehmet Shehu,
Komisar Tuk Jakova
Divizioni II
Me përbërje Br 3,6,18,
Tahir Kadare, komandant,
Kristo Themelko, komisar


Divizioni III
Me përbërje Br 12,14,19,
Islam Radovicka, komandant,
Pandi Kristo, komisar

Divizioni IV
Me përbërje Br 15.17, 18,
Asaf Dragoti, komandant,
Pllumb Dishnica, komisar

Divizioni V
Me përbërje Br 3, 5, 18,
Rahman Parllaku, komandant,
Ramiz Alia, komisar

Divizioni VI
Me përbërje Br 6,7,8,12,
Gjin Marku, komandant,
Myzafer Spaho, komisar

Divizioni VII
Me përbërje Br 2,9, 20
Panajot Plaku, komandant,
Gafur Cuci, komisar



Dali Ndreu

DREJTUESIT E KORPARMATAVE

Korp I (Div 1, 2) Dali Ndreu komandant, Hysni Kapo komisar

Korp II, (Div 3, 4) Tahir Kadare, komandant, Kristo Themelko komisar

Korp III, (Div 5, 6), Shefqet Peci, komandant, Tuk Jakova komisar

*Kjo tabelë nuk pasqyron ngritjet në detyrë dhe lëvizjet e mëvonëshme

PËRGATITI: SAKIP CAMI

Për përgatitjen e këtij materiali u shfrytëzuan historikët e brigadave sulmuese, materiale të uikipedias dhe albumi i AQSh kushtuar 70 vjetorit të çlirimit të Atdheut

81 VJET MË PARË

Kur Brigada e 3-të goditi me top Asamblenë kuislinge

Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokman, në kujtimet e tij thekson: “Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përlëshje ballore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë perëndimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi”, se “nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë”.

Heroizmi luftarak, trimëria deri në përlëshje me armikun, dashuria deri në vdekje mes partizanëve ishin cilësitë e vyera të efektivit. Në luftime dhanë jetën shumë partizanë e patrizane të kësaj brigade si “Heroina e Popullit” Ylbere Bylikbashi, komisarri Birçe Sinomati, dëshmorët Kapo Ademi, Kozma Papa, Sali Ymeri, Ali Dervishi e shumë të tjerë.

Populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, ka përkujtuar dhe festuar me madhësi ngjarjet historike, që tregojnë heroizmin dhe vitalitetin e kombit tonë. I tillë është edhe përkujtimi dhe kremtimi i përvjetorit të 81-të të Brigadës së III-të Sulmuese.

E krijuar më 9 Tetor të vitit 1943, në fshatin Arbanë të zonës luftarake të Pezës, kjo njësi relativisht e madhe për kohën kishte në përbërje të saj partizanë të çetës së Pezës, të batalioneve “Dajti” e “Ishmi”, intelektualë, të rinj, që erdhën nga qyteti i Tiranës, të gjithë me përvojë dhe të kalitur në betejat e ashpra luftarake me okupatorin, i cili synim kryesor kishte likuidimin e forcave partizane në krahinën e Pezës dhe në zonat rrethore të Tiranës.

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake, caktoi detyrat e njëjësive më të vogla, sqaroi situatën politike dhe luftarake, dhe menjëherë ra në ndeshje ballore me armikun në zonën e Pezës dhe në pikat më strategjike në periferi të Tiranës. Rruga luftarake e saj është e gjatë dhe aksionet e saj janë me të vërtetë herokike.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare i ngarkoi detyra të rëndësishme dhe shumë të vështira. Rrugën e saj, brigada e vazhdoi në zonën e Dajtit.

Forcat pushtuese, të alarmuara për aksionet dhe dëmtimet e mëdha që pësonin nga partizanët e Brigadës së III-të Sulmuese, organizuan dhe i bënë prita e rezistencë të madhe, sidomos gjatë kalimit për në Çermenikë e në të gjithë zonën e Elbasanit, ku i shkaktoi armikut humbje në njerëz dhe paisje lufte.

Në kushtet e një dimri shumë të egër, me kufizime shumë të mëdha në veshëmbathje, armatime e ushqime (që të gjitha këto i rrëmbeheshin armikut, por edhe nga populli ndihmohej e furnizohej) mundi t'i plotësojë me sukses detyrat shumë të vështira



kundër një armiku shumë të madh në forca e mjete luftarake.

Një nga aksionet e suksesshme ka qenë mbajtja nën goditje dhe ndërprerja e herë pas herëshme e rrugës Elbasan-Tiranë, gjë që pengonte dhe bënte të dështonin veprimet e goditjet e armikut, që e kishte të domosdoshme lëvizjen në Jug e në veri të vendit. Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokman, në kujtimet e tij thekson: “Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përlëshje ballore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë perëndimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi”, se “nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë”.

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge dhe zhvilluan aksione të tjera edhe në qytetin e Tiranës. Marshimi

luftarak vazhdoi në zonën e Skraparit dhe Përmetit. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në Sukën e Përmetit, të drejtuara nga “Heroi i Popullit” Myslim Keta, iu shkaktoi armikut një humbje e madhe dhe u bë e mundur të shpëtohet jeta e 17 fshatarëve, që ishin të zënë robër e që do të pushkatoheshin.

Brigada mori detyrë që në përbërje të Divizionit të I-rë Sulmues, me luftime të marshonte në drejtim të Verilindjes, Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Kukës-Has dhe për në Malësinë e Gjakovës, nëpër një terren shumë ët thyer e malor, duke kaluar Drinin e Zi e Drinin e Bardhë, në një dimër të ashpër.

Në bashkëpunim me Brigadën e V-të Sulmuese, luftime të ashpra kemi zhvilluar në zonën e Peshkopisë e të Kukësit. Me çlirimin e Tropojës në Tetor, luftime shumë të ashpra e të përgjakshme janë zhvilluar në zonën e Junikut në Kosovë, për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, të qytetit të Gjakovës e të Pejës.

Detyrat luftarake i kemi vazhduar në drejtim të Malit të Zi e deri në Sanxhak të ish Jugosllavisë.

Heroizmi luftarak, trimëria deri në përlëshje me armikun, dashuria deri në vdekje mes partizanëve ishin cilësitë e vyera të efektivit.

Në luftime dhanë jetën shumë partizanë e patrizane të kësaj brigade si “Heroina e Popullit” Ylbere Bylikbashi, komisarri Birçe Sinomati, dëshmorët Kapo Ademi, Kozma Papa, Sali Ymeri, Ali Dervishi e shumë të tjerë. Në Dhjetor të vitit 1945, brigada kthehet në Atdhe duke plotësuar detyrat për çlirimin e Atdheut, gjithashtu edhe në ndihmë të popujve të ish-Jugosllavisë, udhëheqja e së cilës asnjëherë nuk i vlerësoi veprimet luftarake të brigadave e divizioneve tona partizane, pa ndihmën e të cilave do të vështirësohej çlirimi i jugosllavisë. Përkundrazi, udhëheqja e Beogradit, për gjysmë shekulli, shfrytëzoi dhe keqtrajtoi barabarisht popullin shqiptar të Kosovës, duke kaluar deri në genocid dhe asgjësimin fizik të tij. Falë rezistencës kosovare, ndihmës politike, diplomatike e deri me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe mbështetjes së madhe të shtetit e të popullit Shqiptar, Kosova arriti pavarësinë e shumëkërkuar.

Nga Shaban REÇI

Ish kuadër i Brigadës së II-të S dhe ish kryetar i Degës OBVL Tiranë (shkruar në tetor 2002)



80 VJET MË PARË

“Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX-të kishte në përbërje të saj 1580 partizanë



Brigada IX-të Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Ziçishti, komisar; Petro Papi; zv/komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangjel Marko intendent.

Brigada e IX-të S luftoi heroikisht për çlirimin e Korçës

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit. Me marrjen e këtyre qyteteve armikut u pritëshin rrugët e komunikacionit dhe paralizoheshin tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar.

Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj. Brigada kishte një armatim që dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhuruara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor. Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare.

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1150, dhe brigada e XX-të me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave

gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korparmata e 21.

Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse. Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni i II-të duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit-Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës. Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin e I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrave në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një autokolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mblidhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errësirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës. Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futën në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës.

Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër.

Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë

Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme. Ky ishte një sukses në fushën e betejës për dy brigadat që organizuan sulmin. Sukses ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar.

Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX u afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuar me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgjatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut. Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohet edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët.

Kjo i detyroi gjermanët që ta përqëndronin çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autoblindat. Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos edhe depon e municioneve shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët. Ky ishte edhe sulmi i fundit

i partizanëve, të cilët mundën ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe çminimi i zonave të pashpërthyer, operacion që u krye në bashkëpunim me njësitet guerile të qytetit. I gjithë qëllimi i gjermanëve ishte të hidhej në erë qyteti i Korçës, që forcat naziste të kishin mundësi të largoheshin të pa shqetësuar.

Menjëherë forcat partizane dhe më saktësisht batalioni I i brigadës së IX dhe ai I i brigadës së II, u vunë në ndjekje të forcave armike. Forcat partizane iu drejtuan qytetit të Bilishtit, i cili mbahej akoma nga forca naziste. Qyteti u rrethua, por partizanët u gjendën përballë një sulmi të artilerisë armike. Pas shumë përpjekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazemat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek.

Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet Drenovon. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë. Kjo ishte rezultati i bashkëveprimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet për nder të tyre u organizuan koncerte e festime.

Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë.

Por shfaqje të tilla gëzimi kishte edhe në qytetet e tjera si Bilishti dhe gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes.

Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit të IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajoni Krujë-Ishëm-Kavajë

IN MEMORIAM

FADIL HOXHA, FIGURË E SHQUAR E HISTORISË KOMBËTARE

Nga Bashkim Hisari


Fadil Hoxha, Hero i popullit, ishte një figurë me cilësi dhe vlera të veçanta i politikës shqiptare në Kosovë. U shkollua në Shqipëri, në gjimnazin e Shkodrës dhe në Normalën e Elbasanit ku u formua ideologjisht dhe intelektualisht, kurse politikën e ushtrioi në Kosovë. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore themeloi Çetatë Partizane Nacionalçlirimtare të Maleve të Sharrit, Aradhat e para Partizane shqiptare "Zenel Ajdini" dhe "Emin Duraku". Ishte prijës dhe Komandant i Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtar të Kosovës, e cila me rreth 55 mijë luftëtarë, iu bashkua koalicionit antifashist që u kundërvuan dhe luftuan nazi-fashizmin për të ndaluar agresionin e fuqive të boshtit gjerman, italian dhe japonez.

Përcaktimi politik dhe ideologjik i Fadil Hoxhës ishte i mbështetur në pozitën e rëndë të shqiptarëve të cilët në vazhdimësi kërcnoheshin me shumë rreziqe, padrejtësi, dhunë, e madje, edhe me forma të gjenocidit.

Fadil Hoxha ishte përfaqësues emblematic në organizimin e ngjarrjeve historike për popullin shqiptar. Ishte ideator dhe organizator i Konferencës themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dugagjinit të Bujanit ku u miratua një dokument-rezolutë që afirmoi të drejtën për vetëvendosje dhe u votua për bashkim me shtetin amë Shqipërinë.

Më se gjysëm shekulli ushtrioi funksione të larta politike dhe shtetërore. Në një kohë që është karakterizuar me ngjarje të mëdha, Fadil Hoxha, me idetë dhe qëndrimet e tij politike ishte emër i shquar. Qëndroi në ballë të lëvizjes politike e shoqërore të zhvillimeve kulturore e arsimore të popullit shqiptar të Kosovës dhe me këmbëngulje e guxim u angazhua për çlirimin nga trysnia e huaj, për liri, barazi dhe shtetësi.

Në ngjarjet historike që pasuan pas luftës kur shumë prej politikan-



ëve serbosllavë, vazhdonin të jenë frymëzues të nacionalizmit serbomadhdha zhvillonin aktivitete të ndryshme për të shkelur të drejtat dhe formimin e vetëdijes të shqiptarëve dhe për këto qëllime lansonin pohime që fshehnin dhe shtrembëronin të vërtetën, Fadil Hoxha më së miri vrejti se ata, me shpifje e urrejtje zbatonin masa ndëshkuese, krijonin zemërim, pakënaqësi dhe minimizonin shpresën për një të ardhme më të mirë për shqiptarët. Andaj, duke shërbyer në pozita të rëndësishme në administratën jugosllave ai, me këmbëngulje kundërshtoi padrejtësitë, dhunën dhe format e gjenocidit që kërcnonin seriozisht popullin shqipëtarë dhe kërkonte më shumë barazi e të drejta nacionale si dhe u angazhua për zhvillim-

in e demokracisë dhe rritjen e nivelit ekonomik të Kosovës. Theksonte se këto të drejta, populli shqiptar i kishte fituar me pjesëmarrje në LANÇ dhe revolucion që ishin të njohura edhe ndërkombëtarisht.

Synimet për zgjidhjen e çështjes nacionale në dritën e LANÇe dhe për bashkim me Shqipërinë në bazë të drejtës për vetëvendosje, Fadil Hoxha ua parashtrijoi funksionarëve në nivelet më të lartë jugosllave.

Më 21 shkurt 1945 debaton me Edvard Kardelin, revolucionarin jugosllav dhe baskëpuntorin më të afërt të Titos, ku pos tjerash thot: "Mos lejoni që Kosova të ndahet si Sanxhaku në mes të Serbisë dhe Malit të Zi. Le të fitoi drejtësia dhe lufta jonë e drejtë".

Si antar i dy Kryesive të Federatës jugosllave, publikisht kërkoi që Kosova të ketë flamurin zyrtar, stemën, festën e vet shtetërore dhe gjuha shqipe të jet gjuhë zyrtare e detyruar etj. Fadil Hoxha theksonte: "Flamuri i Kosovës nuk duhet të jet një flamur i trilluar. Në Kosovë shumica janë shqiptarë dhe flamuri duhet të jet shqiptarë. Fati i Kosovës është në duar të klasës së saj punëtore, të punonjësve të saj dhe të të gjithë qytetarëve të saj. Kosova ka fituar status të këfillë me luftën e vet gjatë LANÇ".

Duke përshkruar paraqitjet e Fadil Hoxhës në forumet më të larta politike në Jugosllavi, sociologu sloven Sergej Flere, profesor në Universitetin e Mariborit, autor i librit "A duhet të vdiste Jugosllavia?" deklaroi se: "në seancën e Kryesive të KQ të LKJ ku shfaqja e flamurit shqiptar është trajtuar si problem, Serbia nuk e ka lejuar fare, Fadil Hoxha ishte i frustruem nga fakti që

Fadil Hoxha që ishte i vetmi hero i gjallë shqiptar në Jugosllavi, nuk qëndroi jashtë rrjedhave të lëvizjes çlirimtare të popullit tonë, ishte nga shtytësit dhe përkrahësit e luftës së armatosur për realizimin e të drejtave për liri, vetëvendosje dhe pavarësi dhe publikisht përshëndeti shfaqjen e UÇK-së

shqiptarët u penguan të shfaqin flamurin e tyre në fillim të viteve '70. për ç'arsye ai ka liruar stresin, dhimbjen dhe lotët".

Fadil Hoxha u angazhua për hapjen e horizonteve të reja të dijes, për emancipimin e përgjithshëm të arsimit, për zgjerimin e fushë veprimeve të lirisë që reflektohej me shërbimet dhe veprimtarin e tij praktike politike, Synimi i tij ishte emancipues brenda limiteve të pushtetit serbomadhd, ku kërkonte hapsira për të drejtat shoqërore e kombëtare të shqiptarëve dhe një horizont më të gjerë të lirive për të drejtat politike, ekonomike, kulturore dhe sociale të shqiptarëve. Në këtë kontekst, ndër arritjet më me vlerë të Fadil Hoxhës ishte Kushtetuta e vitit 1974. Me të cilin, Kosova ngritet në entitet të fortë juridik në federatën jugosllave. Ishte ërkrahës i denjë i marsheve, protestave e grevave të urisë të minatorëve të Trepçës në vitet 1988-1989.

Fadil Hoxha që ishte i vetmi hero i gjallë shqiptar në Jugosllavi, nuk qëndroi jashtë rrjedhave të lëvizjes çlirimtare të popullit tonë, ishte nga shtytësit dhe përkrahësit e luftës së armatosur për realizimin e të drejtave për liri, vetëvendosje dhe pavarësi dhe publikisht përshëndeti shfaqjen e UÇK-së.

Në veprën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë "Historia e Shqiptarëve", Fadil Hoxha konsiderohet veprimtar politik i rëndësishëm për Kosovën dhe për shqiptarët, organizues e drejtues i LANÇ, besnik i idealit të lirisë njerëzore e kombëtare dhe burrështeti i dalluar i Kosovës dhe i shqiptarëve.

(Vijon në faqen 10)



87 VJETORI I RËNIES

Luftëtari ndërkombëtar, Asim Vokshi

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj


ARSIMIMI I ASIMIT

Kishte dy vjet që zhvillohej Lufta e Parë Botërore dhe në janar të vitit 1916 ushtritë austro-hungareze, duke ndjekur forcat serbo-malazeze për qëllimet e tyre imperialiste, pushtuan pothuajse gjithë vendin. Pushtuesi i ri, për interesat e veta politike e për të lehtësuar mbajtjen e pushtimit dha disa liri të pjesshme, lejoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Për tre vjet, nga 1916 deri më 1919, të pushtimit austro-hungarez, u hapën shkolla në gjuhën shqipe.

Në shtëpinë e Vokshit, në shkollën e hapur, u mblodhën 925 fëmijë. Mësuesi i parë ishte Ibrahim Fehmiu. Shqiptari kishte luftuar edhe për shkollën, të mësonte gjuhën e tij, të bëhej më i ditur. Në qytetin e Gjakovës u hapën dy shkolla fillore me gjashtë klasa. Njëri i emri i Heroit Kombëtar, "Skënderbeg". Ishte viti 1916. Kjo ngjarje e madhe pati ndikim të fortë, si në çdo vatër kosovare, edhe në familjen e Vokshëve të Gjakovës. Më 17 tetor të vitit 1922 u hap shkolla e parë shqipe 6-vjeçare dhe me konvikt, nën kujdesin e Bajram Currit e shokëve të tij patriotë. Konvikti i shkollës në fillim ishte në Kolgecaj dhe më pas u vendos në Krumë. Asimi në vitin shkollor 1926-1927 shkoi në një shkollë më të lartë, në gjimnazin shtetëror të qytetit të Shkodrës dhe u sistemuan në konvikti "Malet tona". Në vitin 1929, Asimi fitoi një bursë shtetërore për të studiuar në auditorët e Akademisë Ushtarake të Këmbërorisë, Kavalerisë dhe Shkollës së Aplikacionit të Këmbërorisë në Modena të Italisë. Studimet zgjatën për dy vjet, në harkun kohor 1929-1930 dhe 1930-1931. Së bashku me Asim Vokshin, në grupin (kursin) e tij, studionin edhe 37 djem të tjerë nga treva të ndryshme të Shqipërisë. Mes studentëve dhe oficerëve të Akademisë, ekzistonin dy rryma, njëra monarkiste dhe tjetra fashiste. Asimi arriti t'i njohë dhe i shfrytëzoi këto për të kuptuar drejt dhe thellë të vërtetën e shkollës që përgatiste ushtarakë të moltipur nga ideologjia fashiste, shtypës për popullin italian dhe mish për top për pushtimin e Shqipërisë e të popujve të tjerë.

DETYRAT USHTARAKE NË SHQIPËRI

Studimet përfunduan në fund të vitit 1931 dhe, më 1 shtator të këtij viti Asimi, me gradën nëntoger, u kthye në Shqipëri dhe u emërua në Pogradec në detyrën zëvendëskomandant i xhandarmërisë së rrethit. Brenda vitit Asimi u transferua përkohësisht adjutant i qarkut të xhandarmërisë në Gjirokastër. Më gjatë se kudo Asimi shërbeu në Delvinë. Në korrik të vitit 1934, Asimi mori njoftimin për një transferim të ri. Këtë radhë në Tiranë, ikte nga baza dhe shkante në qendër. Midis Shqipërisë dhe Italisë fashiste, gjatë vitit 1934, marrëdhëniet u acaruan së tepërmi. Roma e donte ta kishte sa më parë Shqipërinë koloni të plotë të saj. Ajo i bënte presion dhe e kërcënonte. Më 22 qershor dërgoi pa asnjë paralajmërim dhe leje 22 luftanije në portin e Durrësit. Këtë kërcënim regjimi e quajti vizitë



"miqësore". Gjithë politika e tij antikom-bëtare, e brendshme dhe e jashtme, ngjalli zemërim të thellë në radhët e popullit. Mbi këtë bazë, në rrethet përparimtare, që në pranverë të vitit 1934, u shtrua si detyrë e ditës organizimi i një kryengritjeje të armatosur kundër regjimit. Qysh më parë, por sidomos gjatë viteve 1932-1935, Asimi u njoh dhe u lidh me udhëheqës të së majtës në Shqipëri dhe jashtë saj. Madje, në Tiranë ai krijoi dhe kryesonte një organizatë të njohur në historinë e Shqipërisë me emrin "Grupi Komunist i Oficerëve". Në këtë grup bënin pjesë shumë ushtarakë shqiptarë, mes tyre disa shumë të njohur si Bedri Spahiu, Tahir Kadare, Hulusi Spahiu, Dali Ndreu, Prenk Uli, Veli Dedi etj. Asim Vokshi ishte ndër organizatorët e Kryengritjes së Fierit të vitit 1935, në prag të së cilës u arrestua dhe u dënua me burgim.

LUFTËTAR DHE KOMANDANT NË SPANJË

Kur fashistët goditën pabesisht Republikën Spanjolle ai u inkuadrua në rreshtat e Brigadës Internacionale "Garibaldi" si ushtar i thjeshtë. Grupi i oficerëve ishte nismëtari dhe dërgoi për të marrë pjesë në Luftën e Spanjës të viteve 1936-1939. Zotësia që tregonte Asimi në fushën e betejës, përfundimet që nxirrte nga veprimi edhe i ushtarit të thjeshtë, këshillat dhe ndihma për

shokët, shumë shpejt i bindën luftëtarët e batalionit të tretë, të Brigadës "Garibaldi" se kishin të bënin me një njeri që njihte luftën dhe armët e saj, njeri që kishte të bashkuara mirë shpirtin e papërkulur me mjeshtërinë e përdorimit të armëve. Ata kishin vënë re se Asimi hidhej në zjarrin e betejave i papërmbytur, dhe kjo ua rriste moralin shokëve, që të mos i lëshonin llogoret e luftës. Asimi fliste rrallë dhe ashtu i heshtur, më tepër dëgjonte. Shembulli i tij personal në sulm u bë mjet edukues për të tjerët dhe lavdi për popullin shqiptar, që e përfaqësonte denjësisht në arenën luftarake ndërkombëtare. Ai u tregua i pjekur, luftëtar i papërkulur kundër fashizmit dhe mjeshtër i armës. Kur nisnin betejat, komandanti i ngarkonte Asim Vokshit detyrat më të vështira. Ata dhe shokët e tij kishin besim te ai, se ishte ushtar me disiplinë të hekurit i asaj ushtrie ku merrnin pjesë luftëtarë nga pesëdhjetë e tre kombe, zbatonte urdhrat dhe e plotësonte detyrën deri në fund. Asimi i kryente detyrat, mbasi njihte artin e luftës, dinte të përdorte me mjeshtëri armët, kishte guxim dhe ishte gjakftohtë. Kështu, në mes të njëqind e njëzet luftëtarëve, aq sa kishte një kompani, komandant u bë Asim Vokshi. Ai përherë ishte shquar në cilësitë e mrekullueshme për të komunikuar shpejt me njerëzit, me shokët, për t'ua fituar atyre besimin dhe dashurinë.

Por më shumë se kudo, kjo duhej bërë në fushën e betejës, me shokët e luftës. I deshi luftëtarët e kombësive të ndryshme, të cilët po aq e deshën, si vëlla, si luftëtar, si komandant. Te komandanti shqiptar ata kishin besim të pakufi, sepse ai ishte i sakrificës, jepte gjithçka për shokun e luftës. Ku ishte rreziku më i madh, aty gjendej me parë komandanti. Aq i ëmbël ishte në pushim, aq i egër bëhej në vijën e zjarrit, kur shënonte në llogoret e armikut. Asim Vokshi, si ushtar i talentuar, kishte bërë emër në brigadën "Garibaldi". Duke njohur aftësitë e tij organizuese dhe përgatitjen e lartë si ushtar, u thirr në shtatmadhori, e cila e caktoi në shtabin e Brigadës "Garibaldi" oficer të shtabit, për të dhënë edhe ai mendime e për të marrë pjesë në diskutimin të trupave e të luftimit. Në mendimin e komandës së Brigadës, Asim Vokshi ishte tashmë një ushtar i pjekur, luftëtar i vendosur e besnik dhe kishte perspektivë për një detyrë më të rëndësishme, komandant kompanie në batalionin e tretë të Brigadës së 12-të "Garibaldi". Në fund të gushtit të vitit 1937, republikanët kaluan në mësymje në frontin e Aragonit në drejtim të Saragosës, me qëllim që të tërhiqnin vëmendjen e komandës fashiste, e cila ishte hedhur me forcat kryesore në frontin e veriut, duke kërcënuar qytetin e Santanderit në tokën baske. Veprimet luftarake ishin shumë të ashpra e të përgjakshme, të cilat në këtë front, vazhduan deri më tej nga gjysma e muajit tetor. Asimi mori pjesë në luftimet e ashpra të Fuento del Ebros, ku ra dëshmor, në luftimet e datës 4 Tetor të vitit 1937, kur ishte vetëm 27 vjeçar. Në korrik të vitit 1943, vëllai i dytë i Asimit, Derguti, u pushkatua nga fashistët italianë, në Landrovicë të Gjakovës. Hallë Bijë Vokshi i tregon të vërtetën të vëllait, Aliut, babait të Asimit: "Të rrosh vetë vëlla, Dergutin e vranë sot fashistët italianë, Asimin e kanë vra para gjashtë vjetësh në Spanjë!".

NË MEMORIE TË POPULLIT SHQIPTAR, KOSOVAR DHE SPANJOLL

Asim Vokshi, Heroi i Popullit nuk ka varr. Populli këtij biri të vet të pavdekshëm, në vend të varrit, i ka ngritur monumente bronzi, i ka thurur këngë, shumë shkolla dhe rrugë mbajnë emrin e tij, si dhe janë shkruar libra dhe monografi për jetën e tij. Për meritat e tij revolucionare në luftën për lirinë Atdheu e ka dekoruar me "Urdhrin e Skënderbeut të Klasit II" dhe më 10 korrik 1949 Kuvendi Popullor i dha titullin e lartë "Hero i Popullit". Asim Vokshi është çmuar dhe dekoruar nga shteti spanjoll në nderim të veprës së tij si dëshmor. Monumente janë ngritur në brigjet e Ebros së përgjakur. Dita e madhe e lirisë është mbjellë cep më cep në të gjithë tokën spanjolle. Në të gjitha betejat më të ashpra, sidomos ato të Madridit, Haramës, Guadalajarës, Brunetës, Teruelit, Aragonit, Ebros dhe Katalonjës morën pjesë edhe vullnetarët shqiptarë, të cilët nuk mbetën aspak prapa trimave më të mirë të Luftës së Spanjës. Populli spanjoll kurrë s'i ka harruar luftëtarët ndërkombëtarë që u vranë për lirinë e tij.

IN MEMORIAM

Mehmet Hysenaj nga Reçi, njeriu dhe ushtaraku model

Nga SHAQIR ÇERPJA



Trojet e Bajram Beshirit në Kraj Reç

Shtëpia e Bajram Beshirit në Reç të Dibrës, ishte dhe është shtëpi me shumë emër dhe zë. Ajo njihej e njihet, përmendej e përmendet, jo vetëm në Reç e Dardhë, por edhe në Dibër e Kukës, në Mat, Mirditë, etj.

Shtëpia e Bajram Beshirit, me themele të forta, në troje të gurta, ishte vendosur në hyrje të fshatit Kraj-Reç, në një kodër, midis përroit të Sukës dhe përroit të Shqopës, sipër lumit Drin dhe poshtë rrugës nacionale Kukës-Peshkoi. Është një kodër e vogël e në atë kodër të vogël kishte ngritur kullën e kishte shtëpinë një familje e madhe. Në atë kodër të pjerrët e terren të thyer, gjallnonin njerëz të drejtë, por të pathyer nga asnjë vështirësi e pengesë. Në atë kodër të vogël me pak tokë e ara të varfëra përreth, kishin ngritur e ndërtuar jetën e jetesën e tyre njerëz me zemër të madhe e shpirt të pasur bujar.

Familja e Bajram Beshirit ishte familje e madhe, e shquar për tradita patriotike, atdhetare e liridashëse, por edhe për besë e besnikëri, për mikpritje e bujari. Bajram Beshiri kishte nëntë djem, por dy prej tyre, Halili dhe Murati, në vitin 1913 u vranë në Bushtricë të Kukësit, në luftë kundër pushtuesit barbar serb. Organet shtetërore kompetente, me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Dibrës, nr. 72, datë 23 maj 1978, dy vëllezërit Halil Bajram Hysenaj dhe Murat Bajram Hysenaj, janë shpallur DËSHMOR. Emrat e dy vëllezërve dëshmorë, Halil dhe Murat Hysenaj figurojnë të regjistruar në librin e nderit, në regjistrin e dëshmorëve në muzeumin e rrethit të Dibrës.

Familja e Bajram Beshirit ishte familje shumë e madhe, deri në 65 anëtarë dhe disa breza me radhë, qëndruan e jetuan bashkë deri në vitin 1940. Ishte familje shumë e madhe, por kishte organizim të përkryer. Ishte familje me shumë rregull e disiplinë, ku secili anëtarë i familjes dinte, kryente dhe bënte punën e tij. Në gjithë jetën dhe veprimtarinë e familjes mbizotëronte dashamirësia dhe respekti për njëri tjetrin, harmonia dhe mirëkuptimi.

Duke qënë familje e madhe, ajo kishte edhe rreth të zgjeruar shoqëror e miqësor dhe hyrje-daljet në kullën e tij ishte të pandërprera, të vazhdueshme.

Dera e kullës së Bajram Beshirit rrinte e hapur dhe priste, jo vetëm miq e dashamirës të familjes, por edhe njerëz e udhëtarë të panjohur, që i sillte rasti dhe udha, që i zinte nata. Oda e miqëve ishte karakteristike dhe e veçantë. Ajo kishte përmasat 8 m me 8 m dhe kishte sipërfaqe e hapësirë të madhe, të bollshme. Për odën e miqëve kishte personel të caktuar, që prisnin e përcillnin miqtë dhe që kujdeseshin për shërbimin ndaj tyre, ushqimin, fjetjen. Dikush nga familja ishte i caktuar vetëm për kujdesin e kuajëve të miqëve. Në kullën dhe në odën e miqëve të Bajram Beshirit bënte dritë zemra e bardhë dhe shpirti bujar i të gjithë pjesëtarëve të familjes. Mirësia e kësaj familje u bë uratë dhe kjo uratë e bëri këtë shtëpi të begatë.

Në trojet e Bajram Beshirit u lind dhe erdhi në jetë edhe njëri nga nipat e tij, Mehmet Eles Hysenaj.

Mehmet Hysenaj u lind më 26 gusht 1927, në fshatin Kraj-Reç të Dibrës. Ai ishte djali i dytë, midis tre djemëve dhe një vajzë të prindërve Eles Hysenaj dhe Merjeme Doçi (nga Macukulli i Matit). Familja dhe ambienti familjar ishin baza e formimit të tij me cilësitë, vlerat dhe virtetet më të mira dhe më të larta njerëzore. Fisniku i fisëm Mehmet Hysenaj u rrit



Mehmet Hysenaj dhe bashkëshortja e tij, Sulthanë Hysenaj-Çerpja

dhe u edukua me dashurinë për njerëzit dhe punën, me vetëdisiplinën dhe korrektësinë në mardhëni-et njerëzore, familjare dhe shoqërore. Në shpirtin dhe vetëdijen e tij feminare ndizej dëshira, por dhe shpresa për shkollë dhe shkollim. Dhe, me kujdesin e mbështetjen e familjes, por edhe të miqëve të familjes, Mehmeti mundi të shkonte, të vazhdonte mësimet dhe të kryente e përfundonte shkollën në internatin e Burrelit.

Ishte rritur me dashurinë për atdheun dhe lirinë e atdheut. Vepra heroike dhe historia e lavdishme e dy xhaxhallarëve të tij, Halil e Murat Hysenaj, që ranë dëshmorë në luftë kundër pushtuesëve serb, e bënte krenar, por dhe i nxiste ndjenjën patriotike dhe të përgjegjësisë për atdheun dhe lirinë e atdheut.

Në vitin 1943 u krijua Çeta e Sllovës me komandant Esat Ndreun dhe, Mehmeti, sapo mori vesh për krijimin e Çetës së Sllovës, hoqi barrën e kashtës që kishte ngarkuar në shpinë dhe i thirri vëllait të tij, Danit dhe i tha:

-Hajde e merre barrën e kashtës, se unë po shkoj të bashkohem me Çetën e Sllovës dhe do të luftoj për lirinë e atdheut.

Mehmeti shkoi në Çetën e Sllovës dhe u tha se

donte të bashkohej me ta e të luftonte për lirinë e atdheut, por për shkak të moshës së vogël (ishte vetëm 16 vjeç), nuk mund t'a pranonin e nuk e pranuan, por u justifikuan se nuk kishin pushkë për t'i dhënë atij, por dhe e qetësuan, duke i thënë se sapo të siguronin pushkë, do t'a njoftonin që të vinte e të bashkohej me çetën.

Mehmeti u kthye i mërziur në familje dhe u tha se nuk më pranuan në çetë se nuk kishin pushkë për mua. Por më kanë thënë se kur të gjejnë pushkë, do të më njoftojnë që të shkoj e të bashkohem me Çetën e Sllovës. Prindërit i thanë të merrte njërin ka (kaun), t'a shiste në pazar dhe të gjente e të blinte dy pushkë, njërin t'a mbante për vete e tjetrin t'a mbanin rezervë në shtëpi. Dhe, Mehmeti shkoi në pazar, shiti kaun dhe bleu dy pushkë. Njërin pushkë e mbajti për vete dhe pas një viti, kur u krijua brigada e 18 sulmuese, me komandant Esat Ndreun, Mehmeti, mori pushkën dhe shkoi partizan në këtë brigadë partizane, ku ishte, ku gjeti dhe ku takoi edhe Beshir Laçin. Në një nga luftimet heroike të brigadës së 18 sulmuese, në kodrat përballë Zerqanit, Mehmeti plagoset, por pas kurimit dhe përmirësimit të plagës, ai i bashkohet brigadës partizane.

Që nga dita që u rrjeshtua partizan në brigadën e 18 Sulmuese në vitin 1944 dhe deri në fund të jetës së tij në nëntor 1971, Mehmet Hysenaj shërbeu me përkushtim e devotshmëri në radhët e ushtrisë popullore shqiptare.

Pas çlirimit të Dibrës dhe Kukësit, brigada e 18 sulmuese kaloi e luftoi për çlirimin e Prizerenit. Edhe pas çlirimit të Shqipërisë, Mehmeti vazhdoi të shërbente në forcat e brigadës së mbrojtjes së popullit, ku shërbeu deri në vitin 1949.

Në vitin 1949, Mehmeti dërgohet në shkollën ushtarake dhe pas kryerjes e përfundimit të shkollës ushtarake, shërbeu oficer këmbësorie në ushtri në disa rrethe të vendit, si në Tiranë, Kavajë, Pogradec, Kurbnesh, Burrel dhe Shkodër. Kariera e tij ushtarake arriti deri në shef i shtabit të divizionit dhe më pas, për arsye shëndetësore kaloi në detyrën e shefit të prapavijës së Divizionit. Ndërsa në vitin 1965 mori statusin e invalidit dhe u aktivizua si aktivist në këshillin e lagjes në Shkodër.

Në Shkodër, Mehmet u takua edhe me dibranin e shquar dhe me cilësi e vlera vitale, Ahmet Kaçorri dhe u njoh e miqësia edhe me Abdulla Çangën, ish sekretari i Elez Isufit, i cili kishte njo-

hur nga afër edhe Misim Ahmetin, me vajzën e vogël të të cilit ishte martuar Mehmeti. Abdulla Çanga kishte shumë reputacion shoqëror, por edhe pushtet shtetëror në Shkodër dhe nëpërmjet tij, Mehmeti ndihmoi shumë njerëz, veçanërisht punëtorë dibranë, që kishin nevojë për punë, strehim etj, por dhe nxënës në shkollën pyjore, pedagogjike, por dhe në Institutin pedagogjik të Shkodrës.

Kudo që jetoj e shërbeu, Mehmet Hysenaj krijoi dhe la gjurmë të çmuara të sjelljes, qëndrimit, të thjeshtësisë e modestisë, të humanizmit, të korrektësisë, shpirt bardhësisë dhe bujarisë.

Edhe pse kanë kaluar shumë kohë e vite, me shumë respekt e mirënjohje, njerëzit kujtojnë shumë episode nga njohja, kontaktet, ndihma që u ka dhënë dhe bujarinë e Mehmetit. Midis shumë rasteve dhe episodeve, veç të tjerave tregojnë se kur Mehmeti shërbente e jetonte në Pogradec, një pasdite kur ai sapo kishte mbaruar shërbimin dhe ishte kthyer në shtëpi, nga ballkoni i apartamentit të tij në katin e katërt të pallatit, sheh poshtë në trotuar një burrë të veshur me veshje malësore dhe me kësulë të bard-

OPINION



Mehmet Hysenaj

hë. Zbriti poshtë dhe ndoqi malësorin, i cili sapo hyri në hotelin e qytetit për t'u regjistruar që të flinte aty atë natë. Megjithëse as nuk e njihte dhe as nuk e dinte se nga është ai burrë malësor, Mehmeti e takoi dhe i tha të mos regjistrohej në hotel, por e ftoi në shtëpinë e tij, që të rrinte tek shtëpia e tij atë natë. Malësori ishte nga Kukësi dhe kishte ardhur në Pogradec të takonte djalin e tij ushtar. Mehmeti, atë natë thirri në shtëpinë e tij edhe djalin ushtar të malësorit kukësin, i dha disa ditë lejë dhe të nesërmen, malësori kukësin bashkë me djalin e tij ushtar u nisën për Kukës.

Disa vite më parë, njëri nga djemtë e Mehmetit ndodhej në një dasëm në Lurë. Aty në dasëm u njoh edhe me një malësor lurjan, i pranishëm në atë dasëm. Malësori lurjan e fton djalin e Mehmetit, që të shkonte e të flinte tek shtëpia e tij atë natë. Dhe, sapo arritën në shtëpinë e tij, ai hapi valixhen dhe nxori prej saj një fotografi të Mehmet Hysenajt dhe tregoi se Mehmeti e kishte shpëtuar nga burgu, prandaj fotografinë e tij e ruante dhe do t'a ruante përgjithmonë. Në një rast tjetër, djali i madh i Mehmetit po udhëtonte me makinë dhe në Rrogozhinë ndalon dhe merr në makinë një burrë të panjohur. Gjatë udhëtimit, duke biseduar udhëtari e pyeti se nga je e kush je dhe kur mori vesh se shoferi ishte djali i Mehmet Hysenajt, burri i panjohur nga Pogradeci shpërtheu në lotë dhe i tregoi se si kishte qënë ushtar në Kavajë dhe Mehmeti e kishte shpëtuar nga një rast kritik. E fton në shtëpinë e tij në Spitallë të Durrësit dhe thirri gjithë pjesëtarët e familjes dhe u tregoi se ky është djali i Mehmet Hysenit dhe Mehmet Hyseni më ka shpëtuar nga një rast kritik. Dhe një tjetër rast, kur B. Fana nga Shumbati, ish ushtar tankist dhe ai, fshehurazi komandës kishte ndezur tankun dhe kishte provuar t'a manovronte në terren të thyer. Por nuk kishte mundur t'a manovronte dhe tanku ishte rrëzuar, por dhe ishte dëmtuar. Mehmeti mori vesh ngjarje dhe se autori i ngjarjes ishte nga Dibra. Ngjarja nuk kishte ndodhur në repartin ku shërbente Mehmeti dhe as ushtarin dibran nuk e njihte, por thjeshtë se si ishte dibran, Mehmeti u vu në lëvizje dhe nëpërm-

BIJTË E VETERANËVE SI TRASHËGUES TË DENJË TË PARAARDHËSVE TË TYRE



Nga MEVLUD BUCI

Të vlerësosh mirësinë, urtësinë, drejtësinë e veteranëve, është jo vetëm vlerë, por edhe detyrim moral, dhe krahas instancave, shoqatave të ndryshme, këtë së pari e bëjnë bijtë e veteranëve, të cilët më shumë se për çdo përfytyrim, këtë e bëjnë duke u ngjarë paraardhësve në vlerat e tyre e duke krijuar vlera të reja, por asnjëherë nuk e harrojnë historinë, të shkuarën, e kjo është një premisë e fortë për të ecur përpara.

Trinomi finikëri, peshë dhe dritë, është më i sakti dhe më mbresëlënësi që shoqëron e gdhend figurën e veteranëve. Bijtë e veteranëve, si veteran pasardhës, kanë dhe ngrajnë më lart krenarinë e gjyshërve dhe të baballarëve në një kohë tjetër.

Në gusht 2024, ish nxënësi im, ish-kryetar komune, Lazim Hajredin Bardhi, u nda nga jeta. Në ngushëllim tek i vëllai Sadiku, Ruzhdi Bruçi, intelektual i shquar-mjek, pasardhës i veteranëve Dan e Ali Bruçi, tha: "Unë s'kam vëlla më të madh, por vëlla e xhaxha më është bërë Faik Bruçi (kushëri i parë i tij). Ky Hipokrat i kohës di të çmojë vlerat. I ati i tij Aliu, xhaxhai Dani, sikurse Dalipi, Mahmudi janë veteran, gjithmonë transmetues vlerash për Ruzhdiun, i cili ka zgjedhur të lodhet për vendlindjen e t'i japë asaj urtinë e përkushtimin.

Shembujt janë të shumtë dhe nuk të përmbledhen të gjitha në caqet e një shkrimi. Ajo që të impresionon është se kjo traditë mbahet gjallë tek bijtë e veteranëve jo vetëm thjesht si nderim, por si cilësi e virtytit të trashëgimit të vlerave më të mira.

Brezat e sotëm e ata që do të vijnë, nuk e harrojnë e nuk duhet të harrojnë sakrificat e të parëve, luftën, punën, vështirësitë, sfidat dhe kapërcimin e tyre, edhe pse kohërat moderne dhe harresa bën punën e saj.

Në Lezhë, Gani Maliq Lala, krenohet me veteranët në Qafë Murrë. Ai flet me

nderim për Bajram Zenel Lalën, Qazim Prrejsin, Fatmir Delishin, Isuf Nikën, për të gjithë ata që luftuan, ndërnuan vepra, e modestisht jetuan.

Por edhe Ganiu, si bir veteranësh punon e nderon fisin Lala dhe fëmijët i edukon me dashurinë për vendlindjen, duke u kujtuar atyre se ajo nuk duhet harruar.

Tofik Mehmet Totraku, nip i veteranit të punës Veli Totraku, djali i Mehmet Totraku, v rarë nga rrufeja në krye të punës, sot nderon Lukanin e Katër Grykët me fjalët e mira që thuhën për të. Përparim Petrit Lica ish -drejtor shkolle në Lunarë, mësues letërsie i nderuar, flet me adhurim për dajat e tij veteranë, Nikajt e flamurit të Qafë Murrës, të dajave të babës, Metës së Selishtës.

Përkushtimi i tij për punës krahas cilësive personale është njëkohësisht edhe një virtyt i trashëguar brezash. Puna në arsim e në lokalitë e tij në Lunarë e dëshmon këtë.

Të vlerësosh mirësinë, urtësinë, drejtësinë e veteranëve, është jo vetëm vlerë, por edhe detyrim moral, dhe krahas instancave, shoqatave të ndryshme, këtë së pari e bëjnë bijtë e veteranëve, të cilët më shumë se për çdo përfytyrim, këtë e bëjnë duke u ngjarë paraardhësve në vlerat e tyre e duke krijuar vlera të reja, por asnjëherë nuk e harrojnë historinë, të shkuarën, e kjo është një premisë e fortë për të ecur përpara.

Trojet e Bajram Beshirit në Kraj Reç

jet shoqërisë që kishte e shpëtoi nga përgjegjësia dhe dënimi.

Vitet e luftës Nacionalçlirimtare, por edhe vitet e para pas çlirimit, deri në vitin 1949 ishin shumë të vështira për Mehmetin. Ai u plagos në luftë, por plaga e plumbit të luftës u shërua. Por marshimet e gjata luftarake në të ftohtë, në ditë e netë me shi, borë e ngrica, mungesa e ushqimit dhe veshjes, prekën e lanë gjurmë të rënda në shëndetin e tij, aq sa as kurimi periodik nuk e rigjeneruan shëndetin e tij, i cili nuk u përmirësua, por vetëm përkeqësohej në vazhdimësi, aq sa në vitin 1965, kur Mehmeti ishte në moshë të re, 38 vjeç, ai merr statusin e invalidit. Shëndeti i tij vinte duke u dobësuar dhe Mehmeti e shihte se nuk kishte përmirësime dhe e kuptonte se nuk mund t'a ndryshonte fatin e jetës së tij. E parandjente dhe e parashihte fundin e jetës së tij. Por e shqetësonte dhe e mundonte merakun i pas vdekjes së tij. Megjithëse në Shkodër kishte jetuar e shërbyer dymbëdhjetë vjet dhe atje ishte stabilizuar, miqësuar dhe familjarizuar me njerëzit, me lagjen dhe qytetin dhe kishte shumë miq

e shokë, përsëri ai shpirtin dhe mendjen e kishte në vendlindje, donte dhe kërkonte vendlindjen. Dhe, shumë kohë para vdekjes dhe deri në ditën e vdekjes, bashkëshortes së tij i la tre porosi-amanet:

-Trupi i tij të varrosej në vendlindje.

-Pas vdekjes së tij, familja e tij, bashkëshortja bashkë me fëmijët të transferoheshin nga Shkodra dhe të shkonin e të jetonin në Peshkopi.

-Njëri nga djemtë e tij të vazhdonte rrugën e tij, të ndiqte shkollimin ushtarak dhe të vazhdonte karrierën ushtarake.

Në Shkodër, më 20 nëntor 1971, në moshën 44 vjeç, Mehmet Hysenaj u nda nga jeta, duke lënë në pikëllim bashkëshorten dhe fëmijët e tij, tre djem e një vajzë.

Bashkëshortja e tij, Sulltanë Hysenaj, një grua shumë e zonja, një grua shumë serioze dhe krenare, e fortë dhe guximtare, i'a plotësoi tri porositë -amanet.

Ndonëse ishte fund vjeshte dhe moti ishte i vështirë, me shumë borë e ngrica, trupi i tij i pajetë erdhi dhe u varros në vendlindje. Njëri nga djemtë e tij, Bashkimi vazhdoi dhe kreu shkollimin ushtarak dhe ndoqi karrierën

ushtarake deri kur doli në pension. Gjithashtu, familja e tij u transferua nga Shkodra dhe erdhën me banim në Peshkopi.

Gjatë luftës dhe pas luftës, Mehmet Hysenaj njohu, bashkëpunoi dhe u miqësia me shumë njerëz të thjeshtë, por edhe personalitete të rangut të lartë si Hajri Hoxha, Sulë Baholli, Rrahman Parllaku, Hito Çako, Dilaver Poçi, etj. Në veçanti, gjenerali madhor Hito Çako, në vazhdimësi u kujdes për Mehmetin dhe shëndetin e tij, duke vënë në dispozicion e në shërbim të shëndetit të Mehmetit edhe helikopter ushtarak. Pas vdekjes së Mehmetit, vetë Hito Çako, u interesua, u kujdes dhe u angazhua për transferimin e familjes së Mehmetit nga Shkodra në Peshkopi. Për të liruar një apartament në Peshkopi për strehimin e familjes së Mehmetit, Hito Çako urdhëroi transferimin e një oficeri nga Peshkopia në Berat.

Mehmet Hyseni ka marrë vlerësime të larta institucionale, shtetërore. Është dekoruar katër herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Por vlerësimi më i lartë për Mehmetin është respekti dhe mirënjohja e njerëzve ndaj tij.

80 VJETORI I KRIJIMIT

U themelua më 4 tetor 1944 në Bicaj të Lumës dhe kreu beteja të rëndësishme kundër pushtuesve

Më 4 tetor 1944, në Bicaj të Lumës, festohet 80-vjetori i krijimit të Brigadës së 24 Sulmuese. Është një nga formacionet partizane, që ka lënë gjurmë të ndritshme në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke dhënë një ndihmesë të vlefshme në fitoren e lirisë, që e renditi Shqipërinë në fund të kësaj lufte të përgjakshme në krahun e fitimtarëve. Shifra dhe fakte nga veprimtaria e Brigadës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare:

-U krijua me 560 partizanë (siç e kishin filluar dhe brigadat e tjera) dhe brenda muajit tetor 1944, në terrenin e Kukësit, Brigada e kapi shifrën e 1000 luftëtarëve. Në fund, sipas dokumenteve zyrtare, ajo kishte 1185 partizanë, shumica nga Luma, Gora, Dibra, po edhe nga Shkodra, Lezha etj..

KOMANDA E BRIGADËS:

Komandant u caktua Ndreko Rino, "Hero i Popullit", nga Libohova e Gjirokastrës, me parë komandant batalioni në Brigadën e I Sulmuese. Komisar i saj u caktua Abedin Shehu nga Bicaj i Lumës, ish -komunist që në gjimnazin e Shkodrës dhe drejtues i partisë në Qarkun e Lumës, ish-oficer i shkolluar në Itali. Aksioni i parë luftarak i saj ishte një pritë e organizuar në bashkëveprim me Brigadën e XVIII

Nga Brigada e 24 S ranë heronj dhe dëshmorë 15 kuadro e partizanë



luar në Itali. Aksioni i parë luftarak i saj ishte një pritë e organizuar në bashkëveprim me Brigadën e XVIII

S të Dibrës kundër një kolonë gjermane në rrugën Kukës-Prizren. Në fillim të nëntorit 1944 merr urdhër

për të marrë pjesë në Luftën për çlirimin e Tiranës. Nga data 8-10 nëntor, për 3 ditë e net me radhë, Brigada e XXIV S, me një marshim të sfiduar luftarak arrin në Tiranë, ku komanda e saj merr detyrën luftarake: Rajoni i saj do të ishte mes Brigatës së I S dhe Br. XXIII S në krahun e djathtë të rrugës Tiranë-Vorë, nga Autorepartit, Ura e Kamzës, Kodrat e Domjes, (me thellësi deri në Laknas), me detyrë: të godasë dhe asgjësojë forcat gjermane, që vinin për të hyrë në Tiranë nga Vora ose për të dalë nga Tirana për në Vorë. Do të bashkëvepronte me Brigadën e X S dhe batalionin "Antonio Gramshi, të vendosur në anën e majtë të rrugës Tiranë-Vorë, në kodrat e Kasharit".

Brigada hyri menjëherë në luftë me datë 11 nëntor, në etapën përfundimtare të saj dhe për 7 ditë e net, 4 batalionet dhe kompanitë e saj, në kushte të vështira moti (shiu të dendur), në mungesë të theksuar të armëve kundërtanke, u ndesh me forcat gjermane që tentonin të hynin ose të dilnin nga Tirana. Brigada ka zhvilluar këtu luftimet më të ashpra në historinë e saj. Përballë tankeve dhe autoblivande gjermane, partizanët e Brigadës vunë gjokset e tyre duke shkruar faqe heroizmi të pashembullt.

NË KËTO LUFTIME TË BRIGADËS RANË 15 KUADRO E PARTIZANË:

-Vehbi Shehu, Ramadan Shahu, Nuredin Braha, Sadik Palushi, Hakik Gjici, Mahmut Neci,

-Ramadan Kotarja, Xheladin Mici, Abaz Peposhi, Sabri Gjici, Idriz Gafurri, Elmaz Ademi, Osman Qinami, Gani Duraku, Shefit Smana.

Pas çlirimit të Tiranës Brigada merr detyrë dhe nisjet në ndjekje të forcave gjermane, drejt Lezhës dhe Shkodrës. Në këto luftime vritet partizani Xhafer Ollomani. Më 24-27 nëntor Brigada e 24 S lufton e sulmon forcat gjermane në vijën Beltojë-Bërdicë-Bahcallëk, përballë një mbrojtjeje gjermane të përforcuar, të mbështetur fort me artileri të rëndë (të vendosur në Kalanë e Rozafës) me kundërsulme edhe natën.

Në këto luftime të ashpra nga Brigada e 24 S bien 5 partizanë:

-Imer Mata, Isuf Seferi, Islam Xhahu, Emri Halilaj, Hasan Lika. Me 28 nëntor në darkë Br. 24 S zë pozicion në lagjet periferike të qytetit të Shkodrës dhe me 29 nëntor në mëngjes ajo është në mes të qytetit, ku atë ditë parakalon para popullit të Shkodrës, që ka mbushur rrugët dhe pret me brohori çlirimtarët.

JETA E BRIGADËS VAZHDON EDHE PAS ÇLIRIMIT

Për një javë në dhjetor 1944, së bashku me Br. 27 S të Shkodrës, Br.24 S marshoi drejt Ulqinit dhe Tivarit dhe pastaj veprimi në Shkodër, Malësi, Kukës e Shijak, ku u shpërnda në maj 1945.

FADIL HOXHA, FIGURË E SHQUAR E HISTORISË KOMBËTARE

(Vijon nga faqja 6)

Në një rrëfim për media, gjenerali Rrahman Parrllaku, Hero i Popullit dhe Nderi Kombit i cili gjatë LANÇ luftoi në Kosovë dhe viset tjera të ish Jugosllavisë, mes tjerash tha: "Për mua, Fadil Hoxha është më i madhi i të gjithë shqiptarëve, qofshin në Shqipëri apo në Kosovë".

Studiuesit e angazhuar në studime të thella në fushën e historisë, politikës, drejtësisë e sociologjisë, poashtu vlerësojnë lartë personalitetin e Fadil Hoxhës dhe kontributin e tij në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të popullit shqiptar. Akademik Rexhep Qosja thekson se: "Fadil Hoxha gati një gjysëm shekull ushtri ndikim të madh në jetën politike dhe shoqërore të shqiptarëve dhe, në përgjithësi, në zhvillimin politik në

Kosovë dhe ishte politikani dhe shtetari shqiptar që, deri në fund të jetës, ishte i çmuar dhe i dashur në popull".

Në librin e tij "Fadil Hoxha siç e njoha unë", Akademik Ekrem Murtezai, veç tjerash shkruan: "Fadil Hoxha për shqiptarët ka bërë tërë atë që ka qenë e mundur në kushtet mjaft të pavolitshme ekonomike, politike, kulturore dhe ndërkombëtare, duke dhënë optimumin e mundshëm brendapërbrënda sistemit".

Për Akademik Pajazit Nushin, Fadil Hoxha ishte: "dashamir i madh i zhvillimit të arsimit e shkollës shqipe, i zhvillimit të kulturës kombëtare dhe i mendimit shkencor. Ishte këmbëngulës për hapjen e Universitetit të Prishtinës". Akademik Jusuf Bajraktari, poashtu vlerëson lartë figurën e Fadil Hoxhës: "Ishte personalitet historik

në 50 vjetët e fundit në luftë për çlirim e vetëvendosje, ndërtim e shtetformim të Kosovës".

Ndërkaq, Prof.dr. Zejnullah Gruda thekson se: "Përcaktimi i Fadil Hoxhës në anën e forcave antifashiste ishte shërbimi më i mirë kauzës së popullit". Edhe mendimtarë të huaj që merren me studime historike të popullit shqiptar, Fadil Hoxhës i kanë dhënë vend të merituar, sikurse është edhe historiani i Britanisë së Madhe Noel Malkolm.

Të gjitha faktet dëshmojnë se Fadil Hoxha ishte një politikan aktiv dhe i guximshëm, vizionar dhe strateg, politikisht dhe moralisht i vendosur të luftoj për pikëpamjet e tij. Andaj, që nga Lufta e Dytë Botërore, deri në vdekje, ka qenë i ndjekur nga sherbimet sekrete serbo-jugosllave, OZNA dhe UDB-ja duke u akuzuar si separatist, inspirator e bartës i nacionalizmit shqiptar, dhe është kërcënuar me burgosje si dhe është shkarkuar nga të gjitha postet e larta.

Marrëzisht, kohëve të fundit po shfaqen individë që me orvatje të kota në portale kanë zell të njollosin LANÇ bashkë me figurën dhe veprën e heroit të popullit Fadil Hoxha. Me gënjeshtëri ekstreme, mashtrime dhe falsifikime të histories, pa fakte e me dobësitë e tyre tradicionale dhe dogmatike, përpiqen të popullarizojnë injorancën dhe t'a përdorin si instrument për qëllime personale politike. Të vërtetat janë ato që janë, jo ato që dikush dëshiron të jenë. Fadil Hoxha ishte figurë emblematike dhe mbetet në histori si personalitet i madh që bëri gjëra të mëdha për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi.



OPINION

“5 përgjegjje ndaj turfullimeve të z. Vuçiç për luftë” ?!



Gjeneral © Piro Ahmetaj*

Ndërsa këto turfullime, gjithësesi, kanë gjetur një interes të shtuar jo vetëm mbarëkombëtar, por edhe në Ëashington, Bruksel, etj në “kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO”, do perpiqem, të përcjell publikisht disa gjetje dhe përgjegjje/mesazhe strategjike, jo vetëm ndaj Beogradit të pushtuar nga oshillacionet e Millosheviçit:

Së pari, të zgjohet dhe të harrojë endrrat neo-staliniste në Rajon dhe posacërisht për Kosovën martire, pasi përtej të gjithave: “prej datës së çlirimit nga pushtuesit Serb (12 Qershor 1999) Republika e Kosovës, sigurisht që nuk është por dhe nuk ka për tu kthyer më kurrë si pjesë e juridiksionit territorial dhe hartës gjeopolitike të Serbisë”. Pikë.

Së dyti, të lëri përrallat me/pa mbret që nuk i beson as më as Moska, as Dodik, dhe sigurisht as ushtria e radikaleve në Beograd. E vërteta, pra kufijtë dhe harta gjeopolitike e patjetërsueshme janë rrenjosur dhe skalitur me gjakun e dëshmorëve të kombit në shekuj si dhe nga fuqia ushtarake e Aleancës Euroatlantike në 1999. Kështu “përsa kohë të ketë edhe Shqiptarë si dhe prezencë të USA/NATO-s në Kosovë, Serbia ka ZERO shance për të “shpallur luftë”, por dhe ka ZERO fuqi/këllqe për të sulmuar ushtarakisht sovranitetin si dhe tërsinë territoriale të Kosovës”.

Thënë këtë, përsëris thirrjen miqësore për aktorët mëndjehapur në Beograd: “të mos lejojnë që qeveria e Vuçiç, etj mbas Tij, të shpenzojnë kot stër koti mbi 1.5 miliard € në vit nga djera dhe mundi i popullit serb (për armatatosjen nga me Tanke; Mig-29, Rafale, Helikopter, raketa dhe dronë vrasës) pasi e vërteta është se asnjë nga vendet ndërkuftare (përfshi Kosovën) apo Aleancë nuk e rrezikon sovranitetin e Serbisë”.

Së treti, riciklimi manktheve të Millosheviçit (Eprorit) apo trimërimi Juaj (z.Vucic) 25 vjet mbas humbjes së luftës gjakatare, mund të ushqejë militantët si dhe axhendën e radikalëve në Beograd; interesat e krimit të organizuar, apo “laraskat dhe sorrat rreth liqenit

Sigurisht e ndjek me interes strategjik, disi edhe me keqëardhje riciklimin e oshillacioneve si dhe trimërimin mbas luftime të z. Vuçiç, Presidentit të Serbisë (ish-Ministrit të Millosheviçit) si dhe ushtarit të axhendës së Rusisë – Putiniste, se: “do të shpallte luftë për kthimin e gjendjes së mëparshme (para 1999) gjeopolitike në Kosove dhe Metohi ... ” !!



Ujmanit ...”, por kurrësësi nuk munden të trembin kombin Shqiptar si dhe as fuqinë e sprovuar (që gjunjëzoi makinerine kriminale të Millosheviçit në 1999) të Aleancës Euroatlantike (USA/NATO/UK/BE) !

Së katërti, pa mëdyshje, që edhe 25 vitet pas çlirimit të Kosovës apo 31 muajt e luftës neo-naziste të Putinit në Ukrainë: “oshillacionet e Beogradit Zyrtar, i gjej të sikronizuara me interesat gjeopolitike të Rusisë në Ballkan”. Por Kremli ka dështuar për të hapur një front të ri luftime si dhe për të mbajtur ndezur frymën antiperëndimore/USA në rajon. Po ashtu z. Vuçiç, ka (keq) dështuar për të bërë viktimën apo për të pirë nga 5 nëna (Moskë, Ëashington, Bruksel, Pekin, Paris)!

Së pesti, përtej dhe përfshi këtë rast (kërcenimin për shpallje luftime ndaj Kosovës dhe NATO-s...!!) përsëris se megjithë përpjekjet dhe progresin 25 vjeçar për tu larguar nga urretjtja dhe gjakëderdhja shekullore, fatëkeqësisht paqja, siguria, stabiliteti demokratik dhe ardhmëria euroatlantike për 6 vendet e ballanit perëndimor, mbetet ende të kërcënuara kryesisht nga Serbia.

Në shtesë, gjeni edhe “tre rekomandime strategjike” për faktorët shtetërorë si dhe ekspertet/kolegët mëndjehapur në Prishtinë, Tiranë, USA/NATO, etj:

1. Përkundër “dogmave internacionaliste dhe kakofonisë sovraniste”,

Prishtina Zyrtare kurrësësi nuk do duhej/t të marrë (pa u konsultuar) vendimmarrje me impakte strategjike, që minojnë themelet e besimit me “çlirimitarët e vërtetë/USA/NATO, që prej 25 vitesh vijojnë të mbajnë peshë kritike për sigurinë dhe ardhmërinë e Kosovës”. Për më tepër: “riciklimin e dalldisjes/kërcënimeve ushtarake të Serbisë ndaj Kosovës”, të mos i konsiderojnë si oportunitete populiste, por si “përgjegjësi e lartë shtetërore për të ndërtuar Kosovën moderne”, përtej prezencës së NATO-s (që nuk do të jetë e përjetshme); vendin ku, qytetarët pavarësisht përkatësive etnike, fetare dhe politike të ndihen të barabartë para ligjit, si dhe faktorizimin me dinjitet të Kosovës nga konsumatore në kontribuese për sigurinë si dhe integrimin e rajonit në NATO dhe BE!

2. Tirana dhe Prishtina zyrtare, e kanë përgjegjësi të lartë shtetërore dhe historike njëherësh, të zhvillojnë projektin: “2-Shtete Sovrane, 1-Komb i vetëm”, duke mos u fshehur prapagandës ego-centrike që vjen nga fuqia e mbipushtetit dhe mbas “gishtit të përkujdesjes diplomatike”, por duke harmonizuar dhe garantuar SHBA/NATO/BE se kjo “qasje e vonuar” do të kontribuojë për paqen afatgjatë në rajon, sigurisht përfshi edhe Serbinë.

3. Aktorëve me peshë strategjike si dhe Ekspertëve/kolegëve në rajon, Ëashington, Bruksel, etj do t'i ri-sug-

jeroja që perspektivën e paqes dhe stabilitetin e Rajonit, ta para-kushtëzojnë me rikthimin e vetëm dy Masave të Mirëbesimit Reciprok (CSBM), nëpërmjet të cilave Beogradi “të imponohet” se: (a) do të ruajë balancat e fuqisë ushtarake duke mos kërcënuar integritetin territorial të Kosovës; (b) nuk do të vendos instalime dhe as aktivitete ushtarake (25 km distancë ajrore dhe 10 km tokësorë), në kufijtë shtetërore mes vendeve. Këto dy kushte gjithësesi duhen të monitorohen nga USA/NATO/BE, që mbeten faktor kritik për paqen në rajon.

Ndërsa, përkundër riciklimit të urretjtjes dhe gjakëderdhjes shekullore, besoj edhe më fortë se këto turfullime staliniste për luftë mbeten një këmbanë alarmi, për të mbajtur zgjuar kujtesën e popujve të ballkanit se: “paqja mbetet misioni i vetëm, në interes të bashkëjetesës paqësore, sigurisë, mirëqënies së qytetarëve si dhe ardhmërisë euroatlantike të Republikës së Shqiperisë, Kosovës, MV, Malit të Zi, Bonje-Hercegovinës dhe Serbisë”!

* Ekspert për SK, Rajonin dhe NATO-n, Zv/Presidenti i Këshillit të Atlantikut; & ish: Këshilltar për Sigurinë Kombëtare në PD, Këshilltar i Presidentit të RSh; Zv/ShShPFA, Përfaqësues Ushtarak në SHAPE/NATO.

PROFILI

Nderim dhe homazh kryeprijësit të çetës së Bilbilenjve, kapedanit të paepur Bilbil Shako Shakaj (4.10.1832 dhe ekzekutuar me varje në litar më 28.2.1852)

KAPEDAN DHE PRIJËS ÇETE BILBIL SHAKAJ, DËSHMOR I ATDHEUT

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Fshati Rexhin i Kurveleshit është i shquar në histori, ku edhe lindi në fillim të vjeshtës së dytë të vitit 1832 Bilbil Shakaj në një familje me tradita të shquara patriotike dhe atdhetare. Ai u rrit i mëkuar me traditën gojore të papërkulshmërisë dhe të revoltave të herëpashërëshme të fshatit të tij të Rexhinit, të krahinës së Kurveleshit dhe mbarë trevës luftarake të Labërisë. Periudha kur lindi Bilbil Shako përkon me një varg kryengritjesh në gjithë trevat shqiptare, me revoltën e parreshtur ndaj pushtuesve osmanë. Ai shpejt u burrërua dhe i doli në krahë familjes në punët e fushës dhe të malit, por nuk harroi kurrë jataganin dhe dyfekun një traditë si postulat i shekujve për mbrojtje. Fakt është se kur i erdhi koha që të shkonte nizamë e të kryente nizamllëkun formoi çetën e tij të Bilbilenjve duke mos përfilluar ligjin osman të askerlikut. Në moshë të re ishte në shinjestër të përndjekjes së koshareve osmane për mosrespektim të ligjit osman mbi braktisjen që i bëri nizamllëkut. Bilbil Shako Shakaj, shumë shpejt u shndrua në një prijës luftarak popullor, komandant dhe organizator i çetës atdhetare e patriotike që e krijoi vetë dhe e priu vet kundër pushtuesve. Pas rënies në fushën e nderit të kapedan Hodo Nivicës më 1852, Mali i Këndrevicës u bë streha e Bilbilenjve nga ku niseshin aksionet e shumta kundër pushtuesve osmanë.

Çeta e Bilbilenjve ishte e organizuar me rregulla të forta, si repart i vogël operacional. Në luftim me forcat, patrullat bylykët e taboret osmane, radhiteshin mbi 50-60 luftëtarë, nuk ishte një numër fikse për pjesëmarrje në luftime. Armët e Bilbilenjve dëgjoheshin në hapjen e depove të bereqetit, ku çeta e Bilbilit shpërndante produkte për popullin e varfër, prisnin udhën karvanëve, postave të qeverisë (hazinetë). Çdo gjë e bënin për popullin e varfër.

Francezi Ami Boue, vizitor i kohës, në veprën "Turqia Evropiane" shkruan: "Për hajdutët (për kundërshtarët) e Perandorisë Osmane nuk janë të huaja ndjenjat e dashurisë për atdhe, ndjenjat e njerëzimit, të mirësjelljes...luftën çlirimtare. Bilbilenjtë ishin në mbrojtje të popullit. Ata kudo që shkonin ngrinin gjyqet e popullit, për këdo që ishte në shërbim të pushtetit osman. Jeniçerët i dënonin me vdekje, u dignin pallatet e tyre. Bilbilenjtë një vit pas luftës së parë për Janinë (1854), gjatë 1855 kapën më të rrezikshmin e vilajetit, Ahmet benë, që grabiste popullin e Zagorisë, Pelopogonit e Delvinaqit. Veliu i Janinës në pamundësi për t'i kapur dhe asgjësuar Bilbilenjtë, u dha titulli: "Dervenaga"/roje shëtitës malorë, për ruajtjen e grykave, qafave dhe maleve. Bilbil Shakua me Bilbil Resulin/Sejdiun me çetën e tyre nuk pranuan një detyrë e ofiq të tillë, por e dëndësuan më tepër aktivitetin e tyre luftarak.


Çeta faktikisht luftonte bashkëpunëtorët në shërbim të osmanëve, po u dilte në ndihmë të varfërve, kërkonte dhe ujdite marrëdhënie paqësore me krahinat dhe fshatrat, dhe kjo është e dokumentuar me dokumente arkivore, para 171 vitesh, më 1853. Çeta e Bilbil Shakos u bë shqetësim për qeverinë osmane, e cila urdhëroi dërgimin e një ekspedite ushtarake për ndjekjen dhe asgjësimin e çetës. Ishte një operacion i dështuar i osmanëve që zgjati gjashtë muaj; ndërkohë që pas gjysëm viti ndjekjeje në pamundësi për t'i kapur osmanët filluan reprezaljet në popullsinë e Labërisë, vrasjet e djegiet. Për ta shmangur këtë reprezalje masive mbi popullsinë e

Heroizmi i çetës së tij të Bilbilenjve në memorjen e kombit shqiptar dhe gjithë Bilbilenjtë e komanduar nga 26 vjeçari që shkoi me vullnet të plotë në zbatim të fermanit të Portës së Lartë të Sulltanatit për të ruajtur nderin dhe krenarinë krahinore të Kurveleshit nga ndëshkimet radikale, ekzekutimet dhe djegiet masive të shtëpive të banorëve të një prej krahinave më vitale të shqiptarizms. Në kuadër të përgatitjes së dokumentacionit për shpalljen "Dëshmor i atdheut", sipas pikës "a" të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut"

Labërisë, komandanti i çetës dhe gjithë luftëtarët vendosën të vetëdorzoreshin tek xhelatët osmanë të ekspeditës ndëshkuese në fund të shkurtit 1858. Në këtë rast arkivat janë këngët e popullit: "Bilbilenjtë e trembëdhjetë,/Në litarë u sosnë vetë,/Për Bilbil e për Resulë,/Shtatë pashallarë u ç'kulë,.../Shkurti u prishi takëmë,/U hodhi borë të rëndë... Vargjet e tjera sjellin një copëz epope të historisë shqiptare: "Trembëdhjetë male në këmbë,/trembëdhjetë Bilbilenjtë,/trupat varur në Janinë,/nami vajtur në Dovlet,/Kurvelesh ç'i bëre djemtë?./I rrite me halle shumë,/pa rritur i bëre burra,/me aromë trëndeline,/me ujë pirë nga gurra./Një emër trimi u vure,/se trimat një emër kanë,/besën lidhur te flamuri,/per besë në litarë vanë,/fol Bilbil Shakua një fjalë./Dale bej të dredh cigarë,/dal të lidh çepenë mbi ballë,/dal të puth shokët me rradhë,/dal të shoh një herë vatanë./për ta malli do më marrë...".

Në fakt të 13-të luftëtarët u varën në litar në rrepet e Janinës, në qendrën e këtij vilajeti, që kishte një shtrirje në rreth 18,320 km katrorë, nga 87 mijë që kishin katër vilajetet në këtë periudhë (vetëm Pashallëku i Ali Pashë Tepelenës shtrihej dikur në 150 mijë km katrorë).

Bilbil Shakua dhe bashkëluftëtarët e tjerë sfiduan vdekjen me qëndrimet e tyre burrërore para litarit, dhe që është kthyer në një legendë e mit nga këngët popullore, që janë krijuar romane dhe krijimtari artistike. por meritojnë të përjetësohen si fenomen i realitetit të qendresës së shqiptarëve përballë pushtimit osman. Çeta e Bilbilenjve ishte jo një legjendë por një realitet me ndikim të madh në Labëri, Çamëri, Thesproti, e më gjerë. Po kaq e vërtetë edhe fakti që tek rripi i Janinës, ku u varën trembëdhjetë trimat liridashës, çdo vit bien rrufetë dhe rrapit i digjen degët. Edhe drejtësia hyjnore i nderon trimat, më shumë se përkujdesja njerëzore, që për shkaqe nga më të ndryshmet e thënë me delikatesë i anashkalon. Strukturat më të larta të shtetit meritojnë që ta kthejnë vëmendjen dhe nderojë me një përmendore bijtë e Labërisë, ndërkohë që piktori Skënder Milori, duke marrë frymëzim nga vepra e çetës trime,



e përjetësoi atë në tablo. Amaneti i kapedanëve ishte amaneti mbarëpopullor: ruajtja e truallit arbëror, amanet brezash të kombit.

Prijësi e kapedani i çetës të Bilbilenjve Bilbil Shako nuk vdiq nga jatagani as nga plumbi por nga ekzekutimi me varje në litar në degët e rrapit nga pushtuesit. Edhe pse vdiq me varje në litar Bilbil Shako mbijetoi në histori. Bilbilenjtë nuk i la jashtë vëmendjes e vërteta, këngët, librat që tregojnë për veprimet luftarake të përgjakshme në mbrojtje të shqiptarisë.

Për kryetrimin Bilbil Shako Shakaj është përgatitur një bust në vendlindje, ka këngë, libër e monografi, ka emër rrugë, njihet gjerësisht në histori, në Rexhin, në Labëri, në krejt qarkun e Prefekturës e Gjirokastrës dhe në mbarë vendin edhe përtej trojeve aktuale shqiptare aty në rrethinat e Janinës, ku ka edhe eshtrat në një varr të përbashkët për të gjithë Bilbilenjtë, që shkruan epope nderi e lavdie për kombin shqiptar.

Për më shumë këta trima ngelen në këngë të ngritur më 1858: "...Shkurti u prishi takëmë,/U hodhi borë të rëndë.../Bilbilenjtë trembëdhjetë, vanë në litarë vetë...". Për komandantin e çetës së Bilbilenjve Bilbil Shako Shakaj është përgatitur propozim i posaçëm nga Dega e Labërisë së Tiranës, SHHUSH, Shoqata "Rexhini", Kryepaqësia e Rexhinb, bazuar në nenin 5, "Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut", pika "a" të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", që thotë: "Dëshmorë të Atdheut shpallen: "a). personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912". Në fakt që të gjithë Bilbilenjtë meritojnë të shpallen me titullin e lartë të nderit "Dëshmorë të Atdheut" dhe konkretisht për gjithë "Robin Hood-ët" shqiptarë të Labërisë: Bilbil Shako Shakaj, Bilbil Resuli (Sejdiu), Avdul Qëndro, Kasëm Qëndro, Avdul Gaxha, Islam Goxha, Dalip Gana, Hasan Guga, Hysen Çulli, Hamzo Canaj, Myslim Abazi, Rexho Çela, Zubo Çulli. Duke pasur mirëkuptimin të Prefekturës Gjirokastrës, besojmë se edhe Ministria e Mbrojtjes si struktura përgjegjëse për dëshmorët do ta finalizojë këtë nismë konformë kornizës ligjore për dëshmorët në vendin tonë.

ESSE

KULLA E CURRAJVE DHE CURRAJT NË HISTORI

Nga prof. Naun Kule


Një nga librat historik-dokumentar të studiuesit Ismet Balaj është: "Kulla e Currit Plot me Histori". Ky libër i kushtohet burrave dhe burrneshave të një kulle, asaj të Currajve në Fushë-Arrëz të rrethit Pukë. Është një libër me 840 faqe me referenca të shumta dhe mbi 400 dokumenta arkivore, hartuar me informacionet e mbledhura gjatë më se 40 vjet nga autori i përkushtuar ndër vite gojë me gojë e derë me derë në të dy rrethet Pukë e Mirditë, shfletuar ndër faqet e mëse 200 librave, ku mbi 20 dokumenta i përkasin vetëm njërit prej protagonistëve të librit, Pashk Currit si edhe bazuar në një krijimtari shumë të pasur të folkut. Bëmat e banorëve të kësaj kulle janë veprime luftarakë prej vitëve '81- të shekullit XVIII dhe deri më 1945, pra afro dy shekuj e gjysëm. Kjo histori, ende lëvrin në gjakun dhe në genin e disa brezave njerëzorë i cili mbartet dhe gjakon ndër pasardhësit e shumtë të shtuar sot në 46 shtëpi e familje Curraj, disa të shpërndarë në Shqipëri, në Europë dhe në SHBA.

Kësisojë, kur e mbyll faqen e fundit të librit, bindesh se puna e admirueshme shumëvjeçare, humluese dhe studimore e autorit Ismet Balaj, meriton shumë më tepër se lëvdatat e kolegëve, edhe posaçërisht vemendjen e institucioneve përkatëse shtetërore, vlerësimin e brezave dhe përhirimin e intelektualëve bashkëkohore.

Kjo edhe sepse, në përmasat historike, shoqërore dhe politike të asaj kulle, është një pjesë e historisë shqiptare, është historia e njohur e gjithë shqiptarëve, të cilët, kanë mbijetuar pikërisht në sajë të simbolikës së kullës, kalasë a kështjellës, të mësyër herëpashere nga veriu, nga jugu, lindja, a nga deti. Luftëtarët popullorë të Currajve patën motiv kryesor të jetës së tyre: "Nuk due grada, as flori, por due flamurin kuq e zi" që thoshte Nikollë Curri, këngë krijuar dhe kënduar nga rapsodi pukjanë Prendush Gega (Artist i Merituar) i fundit të shekullit XIX dhe i çerekut të parë të shekullit të njetzetë.

Në llojin e vet, libri është letërsi dokumentare, e cila, siç dihet, ka dy shanse; të shkruhet bukur a po të shkruhet saktë...?

Dihe se e bukura, jo gjithnjë është e saktë. Ashtu si edhe e sakta, e vërteta, jo gjithnjë është e bukur për t'u pranuar nga të gjithë. Pra autori i një libri të tillë, doemos do të lëvizë mes këtyre këtyre dy kërkesave gjithnjë me pyetjen pezull, ta shkruaj bukur, duke shmangur ose sheqerosur të vërtetën, a po të them të vërtetën siç ishte. Vështirësia qëndron



në gjetjen e një kombinimi të arsyeshëm midis këtyre dy mënyrave të paraqitjes së realitetit.

Në shumicën e rasteve gjithë përgjigjet e këtij dyzimi konceptual vijnë dhe reduktohen në një, në kompromisin e dy shkencave aq të afërta e të ngjashme sa dhe të ndryshme për nga objekti studimet, siç janë letërsia dhe historia.

Pikërisht ky kompromis, i gërshetuar në një raport të drejtë dhe të barazpeshuar mes letërsisë dhe historisë, do të na rezultonte në një krijim të bukur për t'u lexuar dhe po aq i dobishëm në vlerat informative. Pra autori, kryefund mbetet besnik i zgjedhjes jo vetëm për çka do të na rrëfejë, si edhe për mënyrën se si do të na rrëfejë, pra mjeshtria artistike dhe stili me të cilin do të na e thotë. "Dokumenti historik është i ftohtë", shkruan studiuesi Nasho Jorgaqi në librin "Poetika e dokumentit".

Pikërisht në ftohtësinë indiferente të dokumentit, gjëndet edhe po-

etika e tij, pikërisht tek bukuria e bemave dhe e historisë që ai mbartë dhe përcjellë ndër breza. I vetmi mjet i autorit për ta shndërruar këtë indiferencë të dokumentit në ngazëllim dhe dëshirë për lexuesin, është fjala dhe stili, gjetjet dhe përzgjedhjet artistike sigurisht, në masën që mban dhe mbartë vet dokumenti, heroi ose figura historike. Nëse një dokument i rëndomtë historik, do ta ngarkonim me letërsi a më keq, me letrarizma dhe plagjiatura gramafonash, atëherë vlerat e dokumentit, në vend që të shtoheshin, firojnë e zhbëhen. Çelësi mbetet gjithnjë tek sensi i masës në raportin mes letërsisë dhe historisë si dy shkencat që japin e marrin me njëra-tjetrën.

Pas këtyre shëmbujve dhe parashtrimeve modeste, mund të pohojmë se studiuesi Ismet Balaj qëndron mirë në balancën e këtyre kërkesave metodologjike të krijimitarisë dokumentare, pasi merr përsipër dhe përgjithësisht e realizon mirë staturën e krijuesit artistik,

me gjetje, përshkrime, peisazhe, dhe karaktere që e shoqërojnë gjatë lexuesin, krahas historianit skrupuloz, humluesit pasionant dhe vendosjes së dokumenteve historik në kohën dhe në hapsirën e nevojshme, shpesh herë si gur themeli mbi të cilët lartëson kullën e tij të krijimit, librin e vet, shumë më lart, e më e madhe dhe më jtetëgjatë se kulla fizike e Currajve.

Në të shumtën e faqeve të librit, autori është pasionant i dashuruar tërësisht me gjithçka të mirë dhe të bukur që i ofron historia e Malësisë sonë, me njerëzit aktorë dhe autorë të kësaj historie qindravjeçare, me heronjtë që merr të na i paraqes në luftë dhe në dasma, në burg dhe në gëzime, në lindje dhe në shkuarje, në ikjen nga kjo botë me dhimbjen e zhgënjimit njerëzor për padrejtësitë e jetës, pa e ditur se kë të nëmë e kë të falë...

Kështu ngrihet Kulla e Currajve tek ndritë në historinë e vet shekullore dhe fton brezat për të mos e harruar.

Puna disa vjeçare, këmbëngulëse dhe me durim e autorit Ismet Balaj, ka ngritur një kullë të re, madje jo vetëm të Currajve, por edhe e të gjithë shqiptarëve, si pjesë e historisë kombëtare. Ka skalitur me mjeshtri figurat qëndrore Currajve, si Pjetër, Kolë, Prengë, Zekë dhe sidomos dy prej tyre: Nikollë e Pashkë Curri, (babë e bir), por edhe të grave burrneshat si Frange e Prenda Curri. Karakteristika e veçantë e tyre është qëndresë, lufta kundër të gjithë pushtuesve turq, serbë e malazezë, austriakë, italianë dhe gjermanë (1806-1945) si edhe mbijetesat në kushta shumë të vështira gjatë shekujve.

Kjo kullë, e shpalosur bukur dhe saktë në faqet e këtij libri, është shumë më e volitshme, si histori e fiksuar, e lëvizshme dhe e pranishme, për ta mbajtur pranë si pjesë të vetës, të qenies dhe të kujtesës sonë historike.

Nëse pasardhësit e Currajve do të bënin udhë për t'u ngjitur tek kulla e Currajve, autori ua ka shkurtuar udhën dhe lehtësuar mundin, sepse ua ka sjellë kullën e tyre aty në shtëpinë e gjithësecilit, kudoqë të jetë në Shqipëri, në Europë dhe kudo nëpër botë. Madje jo vetëm Kullën e Currajve, por tërë Malësinë me plot pjesë të panjohura të historisë shqiptare. Në këtë mënyrë, jo vetëm një i Curraj, por çdo lexues do ta kuptojë më mirë se (për ta mbyllur me një fjalë të urtë të autorit Ismet Balaj),

"Pëma, sado të lartë të këtë trungun dhe sado të shpërndara të jenë degët dhe gjetet, ushqimin e marrin nga rrënjët, nga mëma e tyre, toka". Kështu, kudoqë të jetë, ai ka me vete shpirtin e të parëve të sendëzuar në libër, e jo vetëm kaq, por edhe një pjesë të historisë sonë kombëtare.

SUPLEMENTI LETRAT


REALIZIMI I ËNDËRRRËS SË YMER BERBATIT PËR KOSOVËN E LIRË

Në libër, ky autor bën fjalë edhe për shpërdorimin që shpesh herë i bëhet lirisë së fituar me gjak, pasi korrupsioni dhe sjellja e padenjë ndaj popullit tënd, nuk i nderon ata që e drejtojnë atë. Gjithashtu, ai është i shqetësuar për largimin nga vlerat e vërteta kulturore dhe rendja pas imitimeve vanitoze që nuk i thonë asgjë njerëzve të thjeshtë. Indinjatën e tij për këtë, ai e shpreh haptazi: “E tërë kjo shtrëngatë antikulturore evropiane e antikombëtare, u shfaq për shkak të paaftësisë kulturore të shoqërisë shqiptare, e cila nuk ishte në nivelin për ta penguar këtë dukuri antikombëtare të pasluftës, duke shfrytëzuar lirinë e demokracinë

SHPENDI TOPOLLAJ


Nuk e di se sa i njohur është prof. Ymer Berbati dhe vepra e tij në Kosovë, por e di mirë se ai për mua është njëri nga intelektualët atdhetarë më të shquar që ajo trevë shqiptare ka nxjerrë. I veshur me sqimë, i gjatë dhe mjaft i pashëm, i matur në të folur dhe me një shikim të butë dashamirës, ai të bën shpejt për vete dhe mjafton një takim i vetëm me të, që të duket se e ke pasur mik prej një kohe që nuk mbahet mend. Mjafton vetëm kaq, dhe miqësinë me njerëz të tillë, nuk ka nevojë ta vësh në provë. Sa bujare tregohet ndonjëherë natyra, duke u dhuruar disave të gjitha cilësitë, vlerat dhe virtytet që i duhen njeriut për të fituar dashurinë dhe respektin e të tjerëve.

Ka qenë fat që u pamë rreth njëzet vjet më parë tek ajo kafeneja pas Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, dhe pavarësisht se takoheshim shumë rrallë, sa herë vinte në Durrës, gjithmonë e kam quajtu-



ar njërin nga miqtë e mi më të shtrenjtë. Qysh nga viti 1997 kishte botuar disa libra me poezi, romanet “Njëpër jetë”, “Kthimi i Beqir Çaushtit”, “Çakejtë” dhe “Me urtarë të lashtësisë”, dhe plot pesë libra me aforizma etj. dhe kjo ishte më se e mjaftueshme për të kuptuar se ai ishte njëri nga shkrimtarët e talentuar të Kosovës që meritonte konsideratën më të lartë. Por, kjo konsideratë m’u dyfishua, kur aty nga fundi i gushtit, u takuam dhe më dhuroi librin e tij me rreth 500 faqe “Leximi i vetvetes”. Të kuptohemi: ai nuk ka pasur aspak si qëllim të zbatojë atë postulatit e famshëm “Gnothi seauton”, pra “Njih vetveten”, të gdhendur në ballin e hyrjes së tempullit të Delfit, atje në Fokidë, pranë malit Parnas. Ymeri, teksa i kishte kaluar të tetëdhjetat, duke i besuar një kujtesë fenomenale, me ato që kishte parë dhe përjetuar, ndërmerri një mision të vështirë: t’u tregojë brezave fatin që e ndoqi vendin dhe popullin e tij nën pushtimin e egër serb. Ai në epilog shkruan se “Nuk desha që këtë “libër” ta mbyll në varr, pa e lexuar para atyre që janë e do të vijnë pas meje”. Ymer Berbati, tani në moshën e shtyrë, nuk kërkon as të mburret, as të duket, as të bëjë heroin dhe as të ngjisë shkallët e karrierës. Ai vetëm kërkon, ash-tu sikurse ka bërë gjithmonë ndërsa ishte mësues, që me të vërtetat e tij, me shembullin që ndoqi në jetë, të edukojë sa të mundë ndjenjën e dashurisë për atdheun, historinë e lavdishme të tij, kulturën e trashëguar ndër shekuj, përqafimin e mendësive të reja, sidomos ato perëndimore dhe mbi të gjitha, kultivimin e ndershmërisë në ndërgjegjen e njerëzve, si faktor i rëndësishëm bashkimi e përparimi. Se vetëm kështu, njeriu në veçanti apo dhe një popull i tërë, do të dijë të ruajë të paprekur lirinë dhe dinjitetin në çdo rrethanë.

Nga ana tjetër, ai ndihet krenar që gjithçka ka arritur e ka nisur nga hiçi, nga skamja e varfëria, nga përpuzja e deri burgosja, dhe pa prituri që t’u bëhet urë pushtetarëve dhe mendjemëdhenjve kokëboshë. Për të ka mjaftuar shembulli dhe fjala e mësuesve emërmëdhenj si Anton Çeta, Fehmi Agani, Zekeria Rexha e Ali Hadri e shokë, me të cilët ai krenohet. I tillë, do edhe ai të mbetet për nxënësit e tij. Ymeri e nis librin me gjetjen e rrënjëve të të parëve. Vetë ai ishte lindur në Gosë të Kavajës ku qe vendosur pas largimit nga Kosova familja e tij para çlirimit. Kur ai ishte ende fëmijë kishin ikur që andej për t’u kthyer sërish në Kosovë, duke marrë me vete kujtimet



më të bukura, sidomos për mikpritjen që banorët i kishin rezervuar familjes së tij. Dhe sapo iu krijua mundësia, pra pasi erdhi demokracia, nuk ngurroi të takonte Berbatët e Tropojës. Dhe ata që gjeti e pritën me mall.

Nostalgjia që ruante në shpirt, bëri që edhe në Gosë të shkonte dhe të takonte ata që kishin mbetur nga koha kur kishin banuar atje. Ymeri, ndoqi fillimisht hoxhën e fshatit, por kur pa se ai ishte sa i paditur, aq edhe një farë mashtruesi, e kuptoi kotësinë e ndjekjes verbërisht të dogmave fetare dhe këmbënguli që të shkollohej. Ishte ende i parritur kur iu desh të udhëtonte shpesh i vetëm, në borë e acar për të kapur orën e mësimit. E kishte kuptuar se që të ishte dikush në jetë, pra i dobishëm për vete, familjen, shoqërinë dhe atdheun, dukej të arsimohesh. Ai më pas e kuptoi se librat dhe vetëm librat ishin ato që të pajisnin me kulturë dhe të bënin njeri me karakter të shëndoshë.

U mor me veprimtari sportive e letrare dhe nuk reshti së bredhuri në gjirin e natyrës, zakon që nuk e ka harruar edhe tani që vitet i rëndojnë mbi shpinë. Te malet, pyjet, lëndinat ai sheh bukuritë e Kosovës, atje ai shplohët, ripërtërihet e frymëzohet. Ymeri qysh në rini i ka dashur dhe ndihmuar shumë shokët e tij. “Nuk prita ndonjë zgjatje dore, - shkruan ai - por ua zgjata dorën të gjithë atyre që kishin nevojë për mua”. Dhe mbi të gjitha, ai mbeti përherë mirënjohës ndaj të tjerëve që në rrethana të vështira, i qëndruan pranë. Shokët e miqtë ai i konsideronte vëllezër, sikurse nuk i mungonte guximi t’i japë përgjigjen e duhur çdo provokacioni e fyerjeje nga kushdo qoftë ai: nxënës shkolle serb, mësues serb apo nëpunës i administratës serbe. Janë shumë domethënëse tregimet “Xhamat e “përgjakur” dhe “Pllaka e thyer”, ku bëhet fjalë se edhe pllakën te dera e shkollës e Likocit me emrin “Azem Bejta” e kishin coptuar e hedhur në baltë. “Dhembja dhe pikëllimi për pllakën e thyer më pikëllon përjetë”. Serbët edhe fëmijëve të tyre u kishin futur urrejtjen ndaj shqiptarëve. Por mbi të gjitha, ai admiron ata që e kanë të zjarrtë brenda shpirtit të tyre, ndjenjën e lirisë dhe të përpjekjeve deri në sakrificim për ta fituar e ruajtur atë. Ndaj dhe do e gjeje atje ku ishte reagimi i shqiptarëve kundër shtypjes e padrejtësive. Duke ditur se për të tillë burra është



SUPLEMENTI LETRAT

Qasje për një libër arkiv

Nga Liljana Muça

Një libër arkiv, titulluar “Shkolla e parë shqipe në Qarkun e Tiranës, në Shëngjergj 1913-2023”, me autor Qerim Toçi, shkruar me rastin e 110-vjetorit të kësaj shkolle. Autori si një hulumtues i kujdesshëm, tashmë, studimin e tij, brenda pak viteve, e ka konkretizuar me një botim të rëndësishëm. Libri dëshmon për punën e përkushtuar faktike dhe të detajuar në themelet e arsimit shqip në këtë krahinë arsimdashëse.

Autori si bir i kësaj krahine, aty ku ai vetë mësoi ABC-në e gjuhës shqipe, aty ku formimi i tij me dritë diturie merr përmasa njohjeje për botën duke filluar që nga mësuesi i klasës së parë dhe të tjerë në vazhdim formësuan tek Qerimi shkallën e dijeve intelektuale për të marrë përsipër një obligim dinjitoz në pasqyrimin dhe zgjerimin e hartës së arsimimit, jo vetëm në Shëngjergj, por edhe më tej në rrethinat e tij ku punan si mësues mjaft djem e vajza shëngjergjase.

Përmes një hulumtimi rigoroz janë evidentuar dhe bërë të njohur në këtë libër personazhet mësimdhënës deri në kapërcimin e një shekulli.

Libri ka me një paraqitje të mirë grafike, me një përmbajtje historike, gjë që do të bëjë të mundur që mesazhet që përcjell, të jetojnë gjatë, si një arkiv i gjallë dhe i pavdekshëm i historisë, për brezat që do të vijnë, përsa i takon të kaluarës së Krahinës së Shëngjergjit, për të cilën është shkruar deri tani, por tani janë mbledhur dhe paraqitur të gjitha në këtë libër.

Duke e lexuar dhe analizuar librin, së pari arrin në përfundim se autori, bën një analizë të plotë dhe të thelluar të realitetit, duke tentuar për të shkruar me hollësi dhe detaje, që jo vetëm e “mbushin” librin e tij, por e bëjnë atë të besueshëm dhe i japin forcë argumentuese. Duket se qëllimi i autorit është

për të dhënë, gjithnjë, një tablo shumëplanëshe dhe origjinale, të plotë e të besueshme për këdo. Së dyti, autori është korrekt në ato që hulumton, analizon, e shkruan, gjithnjë i paanshëm dhe gjithëpërfshirës.

Duke përjashtuar fantazinë që shpesh here autorët përshkruajnë ngjarje referuese nga historia, në këtë libër Qerim Toçi evidenton ngjarje konkrete, të cilat i referohen dokumenteve të depozituara në arkiva. Pasi lexova me interes librin në fjalë i them Qerimit: “Ke bërë vërtet një përpjekje të lavdrueshme që do t’u shërbejë gjeneratave për të njohur mësimdhënësit e diturisë në krahinën e Shëngjergjit”. -Po e vërtetë. Por jo vetëm kaq, motivi që më shtyu më shumë ka qenë që hapja e shkollës së parë shqipe në Shëngjergj dhe 2 vjet më vonë në Shënmëri të mos mbeteshin vetëm si data historike, por një informim gjithëpërfshirës i kësaj krahine dhe më gjërë, -më thotë autori.”

Dhe vërtet, statistikat referuese deri në kalkulime të detajuara; të mësimdhënësve në total (rreth 690 mësues), të mësimdhënësve dhe kuadrove të dekoruar, të nxënësve kuadro që kanë kapërcyer pragun e shkollave në Shëngjergj për të punuar ane kënd Shqipërisë, janë pasqyra reale e punës hulumtonjëse të autorit. Në vijim të këtij shkrimi po shkruaj të fragmentarizuar pjesë nga parathënia e autorit të librit, për të lënë të hapur intersin për një lexim të plotë informues.

“...Shëngjergji, Shënmëria, Shëngjini e të gjitha fshatrat e tjerë, janë shtrirë në luginën e bukur të Erzenit, fshehur mes maleve”.

“...Për të ruajtur dashurinë për vendlindjen dhe për mësuesit që na mësuara ABC-në e gjuhës së bukur shqipe, për ata që na mësuara se si t’i gjenim dhe të çanim rrugët e jetës, vendosa të shkruaj këtë libër, që mësuesit të jetojnë gjatë në memorien e brezave, në respektin e punës se tyre për përhapjen e dritës së diturisë”.

“...Mësuesit, edhe kur shuhen, janë përmem-



dore të gjalla, të cilët me punën, pasionin, edukimin dhe arsimimin e nxënësve skalitin pavdekshmërinë e tyre ndër breza. Ajo armatë shekullore vrau erërsirën dhe na mësuara për të jetuar më mire. Ata ndihmuara në përmirësimin e kushteve të jetesës, forcuan dashurinë për shkollën, vranë errësirën dhe na mësuara për të jetuar më mire. Pothuajse në fillim të viteve 50, u zhduk analfabetizmi nën moshën 40 vjeç”.

“...I mahnitur nga bukuria e luginës së Erzenit, sola në mëndje edhe festën e mirëpritur të 100-vjetorit të shkollës së Shëngjergjit. Kush ka patur fatin të vizitojë fshatrat e Shëngjergjit, me bukuritë mahnitëse që natyra u ka falur, e kupton se aty mungon një nip apo stërnip si Enver Shëngjergji që të këndojë një këngë për Shëngjergjin dhe muzika të jehojë në zemrën e maleve dhe të luginës së Erzenit...”.

REALIZIMI I ËNDËRRËS SË YMER BERBATIT PËR KOSOVËN E LIRË

(Vijon nga faqja 14)

shquar Drenica, ai derdh në letër gjithë dashurinë e tij për zemrën e saj, Prekazin dhe për ata njerëz të pamposhtur. Ja se me çfarë fjalësh plot ndjenja na e përshkruan ai “... Prekazi është një copë toke shumë e vogël, që lind burra të mëdhenj, burra dragoj me fletë. Prekazi është vullkan i amshueshëm, një vullkan që shpërthen sa herë kalorësit e largët mësyjnë truallin tonë. Në Prekaz jetojnë njerëz, që nga brendësia e tokës së tyre marrin fuqi për t’i mbrojtur me gjak vetrat e shtëpive. Po, Prekazi është kërrthiza e atdheut, shkëndija e të gjitha lëvizjeve në kohë të turbullta, kur atdheut i kanoset përmbytja. Po, kjo copë tokë e zjarrtë, që quhet Prekaz, është Piemonti shqiptar, ku nuk u ndalën luftrat, betejat kundër pushtuesve, e sidomos kundër pushtuesit serb. Prekazi është vendi që nuk njeh robëri, ku liria kurrë nuk shuhet në zemrat e njerëzve”. Atje kanë lindur shumë trima që nuk u bënte dritë syri, dhe atje ai vend u shenjtërua, pasi aty lindi, jetoj e luftoi dragoi mbi dragoj, Adem Jashari që u sakrifikua me gjithë familjen e tij të stërmadhe, për të ndezur rezistencën heroike të UÇK - së, që sëbashku me forcat e NATO - s me SHBA në krye, sollën lirinë e shumëpritur. Dhe ja fjalët lapidare të shkrimtarit: “Jasharët ranë, por Jasharët jetojnë”.

Jetojnë se me aktin e tyre bënë epike. Në librin e tij, që më shumë se sa kujtime, të bëhet se po lexon një roman epokal, parakalajnë lloj - lloj personazhesh, që nga ata besnikët e vendit të tyre, pra njerëzit e idealeve të larta, edhe nga ata që shpirtin ja kanë shitur shejtanit për përfitime e favore apo refugjatë që nuk i përgjigjen si duhet kujdesit të italianëve. Pasazhet ku përshkruhet masakra e ushtrisë dhe paramilitarëve serbë, me urdhër të kasapit Millosheviç dhe kriminelë si Arkani në krye, janë

plot vërtetësi, aq sa lexuesi beson se i ka parë me sytë e tij ato mizori. Edhe më parë, ai na jep skena rrëqethëse kur formacionet partizane, vihen në shërbim të Titos dhe vrasin pa të keq vëllezërit e tyre në rrugë e oborre shtëpishë, çka i detyron edhe ata t’u përgjigjen po me armë. Pra, kur u nënshtrohesh të huajve, këto do të jenë rezultatet edhe pse shumë të dhimbshme; do vrasë vëllai - vëllanë. Kapituj mjaft të rëndësishëm pas peripecive dhe vuajtjeve të shkaktuara nga përzënia prej policisë e ushtrisë serbe, zë mikpritja e popullit dhe administratës italiane, ku Ymeri me gruan e tij tashmë të ndjerë Nailen, një shqiptare dhe veprimtare e rrallë për emancipimin e gruas kosovare, shkuan dhe qëndruara deri sa lufta mori fund. Menjëherë, ata i panë vlerat e mëdha intelektuale dhe njerëzore të tyre dhe e caktuan Ymeri Berbatin si përfaqësues të kosovarëve në kampin e pritjes. Ata kur mësuara se ai ishte dhe poet, e përfshijnë në takime, konkurse dhe festivale të ndryshme. Dhe kur konstatuan erudicionin e tij dhe interesimin e tij të madh për kulturën italiane, e sidomos për atë arkeologjike, e shëtitën qytet më qytet dhe e pritën me gjithë të mirat nëpër shtëpitë e tyre. Askund më parë nuk është përshkruar kjo mikpritje dhe dashamirësi e italianëve, sesa në këtë libër, gjë që ta shton respektin për ata njerëz të qytetëruar e zemërbardhë. Ymeri, nuk ngurron të shprehë keqardhje për faktin se vlerësohej më shumë në vend të huaj sesa në atdheut e tij. Po ashtu atje, ai viziton qytete dhe fshatra arbëreshe ku ngazëlleshet jo vetëm nga dashamirësia dhe ruajtja e traditave, zakoneve e gjuhës prej tyre, por edhe nga liria me të cilën qeveritë e atij vendi u kishin garantuar atyre. Bukuritë e Italisë janë marramendëse, por Ymer Berbati, mendjen e kishte tek ai pluhuri i dashur i Kosovës së tij, ndaj dhe kthehet në Kosovën tashmë të lirë, ku jo gjithçka shkante siç e kishte dashur.

Megjithatë, ai po aty marton të birin Tomorrit me vajzën e mirë Teutën, ditën e shpalljes së Pavarësisë, pra më 28 Nëntor 1999, duke rregjistruar kështu të parën dasmë të pas luftës në tërë Kosovën. Në libër, ky autor bën fjalë edhe për shpërdorimin që shpesh herë i bëhet lirisë së fituar me gjak, pasi korrupsioni dhe sjellja e padenjë ndaj popullit tënd, nuk i nderon ata që e drejtojnë atë. Gjithashtu, ai është i shqetësuar për largimin nga vlerat e vërteta kulturore dhe rendja pas imitimeve vanitoze që nuk i thonë asgjë njerëzve të thjeshtë. Indinjatën e tij për këtë, ai e shpreh haptazi: “E tërë kjo shtrëngatë antikulurore evropiane e antikombëtare, u shfaq për shkak të paaftësisë kulturore të shoqërisë shqiptare, e cila nuk ishte në nivelin për ta penguar këtë dukuri antikombëtare të pasluftës, duke shfrytëzuar lirinë e demokracinë. Mësuesit, profesorët e intelektualët dhe, para së gjithash, politikanët para këtyre dukurive sillëshin si të përgjumur, duke mos parashikuar pasojat që do të sillte pluhuri aziatik për Kosovën dhe për shqiptarët në tërësi”.

Me këto kujtime të shkruara plot elegancë, sinqeritet dhe gjuhë të ëmbël e korrekte, çka na thotë edhe për punën plot përgjegjësi të bërë nga redaktori Sulejman Dërmaku, Ymer Berbati, na jep jo thjeshtë jetëshkrimin e tij, por atë të një populli të tërë. Këtu, ai nuk lexon vetveten, por këdo si vetvetja. Ndaj do të ishte e nevojshme që të ketë sa më shumë lexues. Se libra të tillë, do të ishte e domosdoshme t’i njihnin edhe politikanët e huaj, se vetëm kështu do të ishin të drejtë në kërkesat, sugjerimet dhe vendimet e tyre. Vetëm kështu do të përkrahin çdo nisativë të qeverisë së Kosovës, për ta shpënë vendin drejt përparimit, pa qënë nevoja t’i bëjnë presion për lëshime asaj, duke u buzëqeshur e duke marrë me të mirë agresorët e ndërsyer nga politikani me dy faqe Aleksandar Vuçiçi.

AKTUALITET

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përgëzoi të rinjtë për zgjedhjet e kësaj rruge që kërkon sakrificë

239 vajza e djem, të gatshëm të bëhen pjesë e FA

Mes 239 kandidatëve të kualifikuar në përfundim të procesit të rekrutimeve për ushtarë/detarë, të drejtën për të vijuar kursin e kanë edhe 33 vajza; 25 kandidatë janë me arsim të lartë; 160 me arsim të mesëm dhe 54 kandidatë janë me arsim 9 - vjeçar

E hënë, 16 shtator 2024 - 239 vajza e djem janë përzgjedhur për të zhvilluar Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, që është një hap i parë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e përcjelljes, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përgëzoi të rinjtë për zgjedhjet e kësaj rruge që kërkon sakrificë, duke thënë se janë një shembull frymëzues për të gjithë.

"239 djem dhe vajza, mes shumë pikëpyetjeve keni bërë hapin e madh drejt këtij sheshi, duke vendosur të ecni në një rrugë ndoshta më të vështirë por gjithashtu më të bukur dhe më përm-bushëse, si çdo rrugë që qëndron mes investimit në dije dhe investimit në vlera. Me siguri ky rrugëtim i ri, do të sfidojë karakterin, forcën dhe intelektin tuaj. Por në këtë udhë, ju do të keni për krah jo vetëm njëri - tjetrin, por edhe përkushtimin e të gjithë stafit akademik të kursit bazë, të cilët dua t'i falënderoj dhe t'i uroj këtu, pasi kanë detyrën e vështirë të dëshmojnë çdo ditë se Forcat e Armatosura janë një familje e madhe, ashtu si familja që ju ka rritur e sjellë këtu sot për të nderuar veten dhe vendin", - theksoi ministri Vengu.

"Ndoshta duke vendosur të jeni këtu sot, keni hequr dorë nga disa komoditete, por me këtë sakrificë vjen edhe ndjenja e krenarisë, jo ajo



krenaria boshe dhe kryeneçe, por krenaria e detyrës së kryer, krenaria e përmirësimit të vetes dhe të shoqërisë, krenaria e shërbimit dhe e sfidës së

tejkualuar si një skuadër e vetme, e pakrahueshme me asnjë ndjesi tjetër", - theksoi ministri i Mbrojtjes. Ministri Vengu, porositi të rinjtë të ruajnë

me krenari simbolet kombëtare dhe të jenë shembull i respektit ndaj traditave tona. Mes 239 kandidatëve të kualifikuar në përfundim të procesit të rekrutimeve për ushtarë/detarë, të drejtën për të vijuar kursin e kanë edhe 33 vajza; 25 kandidatë janë me arsim të lartë; 160 me arsim të mesëm dhe 54 kandidatë janë me arsim 9 - vjeçar. Të kualifikuarit kanë kaluar me sukses të gjitha testimet e zhvilluara: fizik, intelektual dhe testimin psikologjik. Gjithashtu kandidatët e kualifikuar plotësojnë edhe kushtin e sigurisë, verifikuar nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Policia Ushtarake.

Pjesë e Forcave të Armatosura mund të bëhet çdo i ri nga mosha 18 - 27 vjeç që nuk ka probleme me ligjin dhe ka një figurë të pastër morale.

Stërvitja Individuale Bazë (SIB), e cila konsiderohet si porta hyrëse për çdo të ri në Forcat e Armatosura dhe njëherësh edhe si shkolla e parë e edukimit ushtarak, nis sot, më 16 shtator dhe do të zhvillohet deri më 22 nëntor të këtij viti. Në përfundim të kësaj stërvitjeje intensive, rekrutët do të betohen për të shërbyer më pas në reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura. Të gjithë të rinjtë që bëhen pjesë e FA përfitojnë një trajtim dinjitoz financiar dhe mundësi mjaft të mira për karrierë.

REPORTAZH

Përmeti i zbukuruar për 81-vjetorin e çlirimit, feston ditën e lirisë



Muharem Kamani

Në orët e para të mëngjesit të 13 Shtatorit Përmeti u gdhi i zbukuruar me flamuj e banderola për festën e çlirimit të tij në këtë 81-vjetor. Sheshi kryesor i qytetit "Abdyl Frashëri", fasada e përmendores së partizanit fitimtar kishin marrë pamje festive, dëgjohej muzikë këngë e mar-she partizane plot gjallëri dhe optimizëm.

Punonjësit e gjelbërimit si për çdo festë kishin përgatitur kurora dhe lule të freskëta.

Në këtë festë morën pjesë pasardhës të veteranëve e të familjeve të dëshmorëve, qytetarë dhe punonjës të institucioneve kryesore në rreth e të bashkisë.

Nderuan me pjesëmarrjen e tyre nënkryetarët e Bashkisë Përmet, Aulona Meshini e Florand Hasani, nënprefekti i Përmetit Edvin Tuçi, drejtues të institucioneve kryesore në rreth e të partive politike që mbrojnë dhe respektojnë datat dhe ngjarjet historike të LANÇI. Çaste solemne e krenarie vendosja e kurorave dhe tufave me lule pranë përmendores së partizanit fitimtar. Në emër të Institucionit të Bashkisë kurorën e vendosën Aulona Meshini e Florand Hasani, të Prefektit të Qarkut Gjirokastër Edvin Tuçi dhe major Fadil Guci. Festa vazhdoi në QKMF "Odise Paskali" në sallën e konferencave e konceptuar si mbledhje jubilarë përkujtimore për këtë datë lapidare për Përmetin dhe koncert festiv e organizuar nga Bashkia Përmet, QKMF dhe shkolla 9-vjeçare "Meleq Gosnishti".

Konferencierja Kozeta Thanasi Jashari e veprimtarinë me një fjalë përshëndetëse dhe mirseardhje

për të pranishmit të cilët i bëjnë nder vehtes së tyre që janë të pranishëm.

Aulona Meshini përshëndeti në emër të Institucionit të Bashkisë dhe të kryetares Alma Hoxha. Ajo u ndal te rëndësia historike e kësaj date jo vetëm për Përmetin po për krejt Qarkun e Gjirokastër dhe rrjedhën që morën ngjarjet duke rritur moralin e popullit për fitoren e LANÇI që na solli lirinë që gëzojmë sot. Në kumtesën e tij Tomorr Kotorri që përshëndeti në emër të kryesisë së OFD, foli gjerësisht për këtë datë e rrethanat që çuan në çlirimin e Përmetit.

PAK NGA HISTORIA

Në luftimet e zhvilluara morën pjesë çetat e Skraparit, Dangëllisë, Përmetit e Badëlonjës. U zhvilluan luftime në periferi si në Kosinë, Devojkë, Tremisht. Prefekti i Përmetit ishte Alqi Kristo dhe Kryetari i LANÇI ishte Dr.Musa Ohri. Fashistët italianë si rezultat i këtyre luftimeve ishin mbyllur në gazerma dhe po ngushtoheshin dhe rrethimit. Ata propagandonin në popull për punësime në Itali.

Çlirohen me radhë krahinat. Çeta e Skraparit goditi postëkomandën në Frashër dhe më 11 Tetor 1942 çlirohet krahina e Dangëllisë. Më 12.Nëntor 1942 largohet nga krahina e Malshovës postkomanda nga çeta e Zagories dhe ajo territoriale.Me largimin e postëkomandës fashiste nga Hotova çlirohet dhe krahina e Cëries. U çlirua dhe krahina e Rrëzës. Forca të batalionit partizan "Naim Frashëri" rrethuan garnizonin fashist në Përmet duke i ardhur në ndihmë çeta e Skraparit e cila kaloi vahun mbi lumin Vjosë në fshatin Buhal, doli mbi Bolëngë dhe ngushtoi rrethimin. Duke parë situatën ata braktisën gazermat dhe u tërhoqën në panik në drejtim të grykës së Këlcyrës. Ne përulemi para gjakut të dëshmorëve të cilët sakrifkuan jetën e tyre dhe "Heronjëve të Popullit" Musa Fratari, Skënder Çaçi, Meleq Gosnishti e Gjeli Argjiri dhe dëshmorëve Abedin Shkëmbi, Çome Mendi, Stefan Zhaka, Syrja Sakollari etj dhe dëshmoreve vajza Fanjo Çiçako, Dhoksi Dhame e Zyryha Xhako. Vetëm këtë vit që përkon me 80-vjetorin jubilar të çlirimit, kanë 80-vjetorin e rënies 71 dëshmorë të rrethit tonë. Homazhi e nderimi më i madh për ta është të ruajmë e të riparojmë simbolet lapidarë dhe pllakat përkujtimore dhe varrezat e dëshmorëve në bashkëpunim me pushtet-



tin vendor.

Historiani Kastriot Bezati bëri një ekspozë historike. Ai theksoi se: "Përmeti u pushtua më 11 Prill 1939 e u çlirua më 13 Shtator 1943 duke qëndruar i pushtuar për 1615 ditë. U zgjerua lufta antifashiste nacionalçlirimtare me krijimin e çetave dhe batalioneve të cilat çuan në çlirimin e krahinave.

Një nga betejat më të mëdha të luftës çlirimtare ishte ajo e Kuqarit në Korrik 1943 ku u angazhuan forca partizane nga Qarqet Gjirokastër, Korçë dhe Berat.Vëndkomanda e forcave partizane pjesëmarrëse në luftime për disa ditë u vendos në fshatin Vëlçisht në shtëpinë e Dëshmorit Patriot Riza Vëlçisht me komandat Nexhip Vëlçani.Pas ditës së çlirimit në Përmet shkeli dhe tre herë çizmitja e pushtuesit, në Nëntor 1943, Janar-Shkurt 1944, Qershor 1944, plot26 ditë por nuk ngriji dot organet e pushtetit.

Nga Përmeti lufta partizane u drejtua për 14 ditë e 61 ditë nga Odriçani, plot 75 ditë si asnjë qytet tjetër nga SHPUNÇ. Në Përmet u krijuan dy BrS partizane. Dhanë jetën 189 dëshmorë, nga këta vetëm për çlirimin e Tiranës 11.

Përmeti u dogj nga pushtuesit katër herë dhe nuk është shpallur "Qytet martir i luftës së dytë botërore" siç është shpallur Peza, Mallakastra dhe Kuçi i Kurveleshit", e përfundoi fjalën e tij oratori.

Nxënësit e ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare "Meleq Gosnishti" dhanë një program artistik muziko - letrar me këngë e recitime përgatitur enkas për këtë festë me tematikë nga krijimtaria për LANÇI.

Moderatore e këtij programi ishte Kozeta Thanasi Jashari dhe udhëheqëse artistike Mimoza Topoviti Zyba. Ata interpretuan me nivel të lartë artistik, / Grusht çelik brigadë e gjashtë,/Malet me blerim mbuluar,/ Poezi për heroin Meleq Gosnishti,/Partizani në luftë po shkante,/Kemi derdhur gjak me okë,/Ku e kam vajzën ku e kam djalin,/Nënë moj do pres gërshtetën,/ etj, të cilat krijuan një atmosferë të zjarrtë festive e u mirëprit nga të pranishmit.

*Përmet më,13 Shtator 2024.